

STRATEGJIA E TURIZMIT E KOMUNËS SË FERIZAJT 2023-2027

FERIZAJ, 2022

P ë r m b a j t j a

Lista e shkurtesave....4
Lista e figurave....5
Lista e tabelave....6
Grupi punues....7
Fjala hyrëse nga Kryetari i Komunës....8
Përmbledhja ekzekutive....9
Hyrja dhe sfondi 10
I. Rezultatet e mbledhura nga pasqyra e literaturës, dokumentet programore, planet, strategjitë dhe studimet e tjera të Komunës së Ferizajt....12
I.1 Rishkimi i literaturës 12
II. Metodologjia.... 13
III. Misioni.... 15
IV. Vizioni 15
V. Analiza e gjendjes aktuale....15
V.1 Historiku i Ferizajt....17
V.2 Pozita gjeografike e Ferizajt....17
V.3 Relievi i Ferizajt....18
V.4 Klima në komunën dhe qytetin e Ferizajt....18
V.5 Infrastruktura rrugore në Ferizaj dhe banimi (rrugët, trotuaret, parkingjet, shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive) 18
V.6 Rrugët....19
V.7 Trotuaret....19
V.8 Parkingjet....19
V.9 Popullsia –shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive....20
V.10 Karakteristikat ekonomike të qytetit (primar, sekondar, terciar)....20
V.11 Karakteristikat sociale të qytetit (arsimi, shëndetësia, shërbimet, kultura, feja)....21
V.12 Shëndetësia....22
V.13 Shërbimet....22
V.14 Kultura....23
V.15 Objektet e kultitit apo fesë....23
V.16 Shfrytëzimi i mjeteve motorike (kolektive, individuale)....23
V.17 Shfrytëzimi i mjeteve pa motor (ecje, çiklizëm, etj)....24
V.18 Transporti hekurudhor....24
VI Turizmi dhe Trashëgima kulturore....25
VI.1 Stacioni i Trenit....25
VI. 2 Biblioteka publike “Sadik Tafarshiku”....26
VI.3 Xhamia dhe Kisha në një oborr....26
V.4 Ish-Gjimnazi “Ismail Qemali” 26
V.5 Ish-konvikti për studentë....26

VI.6 Teatri i qytetit.....26
VI.7 Mulliri i Nikës.....27
VI. 8 Bifurkacioni.....27
VI.9 Xhamia e Berishëve..... 27
VI.10 Mulliri i Selman Begës.....27
VI.11 Shtëpia-Kullë e Hasan Fazlisë.....28
VI.12 Kroi i periudhës Iliro-Romake.....28
VI.13 Gjetjet arkeologjike në Nikadin.....28
VI.14 Ansambël ndërtesash në Jezerc.....28
XVII Përkufizimi i problemit.....32
VIII. Krahasimi me vendet/komunat tjera.....32
IX Analiza e problemit dhe mundësive për zgjidhje.....32
X Sëot Analiza.....33
XI Analiza e indikatorëve zhvillimor.....34
XI.1 Vizitorët 35
XI.2 Kapacitet hoteliere të Ferizajt.....37
XI.3 Trendet globale të Turizmit.....39
XI.4 Përjetimi/eksperienca.....40
XI.5 Transformimi digjital.....40
XI.6 Siguria.....40
XI.7 Qëndrueshmëria.....41
XI.8 Tregjet e reja.....41
XII Analiza e katër parimeve-Komuna e Ferizajt.....42
XIII Sfidat kryesore për zhvillimin e turizmit në Komunën e Ferizajt.....46
XIV Prioritetet strategjike për zhvillimin e turizmit në Komunën e Ferizajt.....46
XV Qëllimi bazik dhe operativ i strategjisë të Komunës së Ferizajt.....47
XVI Akterët dhe funksionet relevante kryesore të turizmit në Komunën e Ferizajt.....49
XVII Objektivat e përgjithshme.....53
XVII.1 Objektiva e përgjithshme 1: Infrastruktura fizike 53
XVII.2 Objektiva e përgjithshme 2: Marketingu dhe digjitalizimi.....56
XVII.3 Objektiva e përgjithshme 3: Jezerci dhe Neredimja.....59
XVIII Projektet e dala nga hartimi i draft strategjisë.....60

Lista e shkurtesave

KOMUNA FERIZAJ

USHAF – Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

OHTK – Oda e Hotelerisë dhe Turizmit në Kosovë

Shoqata "JEZERCI"

SHBA "LYBETENI – Shoqata Bjeshkatare Alpiniste "Lybeteni"

OJQ "Avonet"

ASK-Agjencia e Statistikave të Kosovës

DZHET-Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

DKRS – Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

QKZHQ – Qendra Kosovare për Zhvillim të Qëndrueshëm

Lista e figurave

Figura 1: Pozita gjeografike e komunës, qytetit dhe qendrës së qytetit
Figura 2: Indikatorët zhvillimor
Figura 3: Numri i vizitorëve vendor dhe të huaj dhe netë-qëndrimet e tyre në Regjionin e Ferizajt në vitet 2020-2021
Figura 4: Numri i ardhjeve të turistëve ndërkombëtar (1950-2030)

Lista e tabelave

Tabela 1. Hapat kryesor gjatë hartimit të strategjisë

Tabela 2. Temperatura mesatare e muajit gjatë vitit

Tabela 3. Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme

Tabela 4. Numrin e vizitorëve vendor dhe të huaj dhe netë-qëndrimet e tyre në Regjionin e Ferizajt në vitet 2020-2021

Tabela 5. Kapacitetet hoteliere në Regjionin e Ferizajt

Tabela 6: Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjioneve

Tabela 7: Numri i vizitorëve vendor dhe netë-qëndrimet e tyre për periudhat TM4, 2019 – 2021

Tabela 8:Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netë-qëndrimet e tyre, sipas regjioneve për TM4, 2019 – 2021

Tabela 9: Analiza e katër parimeve-Komuna e Ferizajt

Tabela 10. Prioritetet dhe qëllimet strategjike

Grupi punues:

Lulzim Aliu – Nënkryetar i Komunës së Ferizajt

Balton Dërguti – Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizmit

Liridon Jetishi - Kryetar i Grupit Punues

Hysen Sogojeva – Kryetar i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës

Afërdita Hoxha – Kryetare e Odës së Hotelerisë dhe Turizmit në Regjionin e Ferizajt

Selim Marevci – Zëdhënës i Komunës së Ferizajt

Halil Halili – Qendra Kosovare për Zhvillim të Qëndrueshëm

Aziz Rexhepi - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Alberta Tahiri – Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Agon Hashani – Profesor i Historisë

Elbasan Osmani - Shoqata "Jezerci"

Astrit Grainca - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës

Adnan Hashani – Profesor i Gjeografisë

Artan Ismajli – Shoqata Bjeshkatare Alpiniste " Lybeteni"

Kenan Gashi – OJQ "Avonet"

Ilir Bytyqi – Udhëheqës i Njësisë ssë Muzeut

Petrit Hasanaj-Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Faton Spahija- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Gentiana Gashi- Oda e Hotelirsë dhe Turizimit të Kosovës

Manjolla Salihu- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Besim Ugzmajli- Regjisor

Kontribut të veçantë në hartimin e kësaj strategjie ka dhënë edhe profesori universitar z.Lulzim Shabani, si dhe z.Denis Rashiti - Zyrtar në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, znj.Ebrare Guri, znj.Mirsie Derguti, znj.Yllka Grainca dhe z.Flamur Sallahu.

Fjala e Kryetarit të Komunës

Strategjia për Zhvillimin e Turizmit për Komunën e Ferizajt 2023-2027, është një nga dokumentet themelore që identifikon atë se çfarë në të vërtet është Ferizaj, një qytet simbol i zhvillimit ekonomik, potencial i jashtëzakonshëm i turizmit dhe një mundësi më shumë si për qytetarët anembanë vendit, ashtu edhe për vendasit, bashkëqytetarët tanë ferizajas dhe natyrisht, vizitorët e bizneset e shumta vendore e të huaja.

Duke qenë kështu, një dokument i tillë, vë pikat e orientimit dhe planifikimit afatgjatë, serioz e të mirëllogaritur për të ardhmen në këtë fushë. Shto kësaj faktin, se në një përmasë të tillë, me thellime profesionale të tilla, ky dokument paraqitet për herë të parë.

Ferizaj, ka potencial të turizmit, reflektuar kjo në dy pikëpamje. E para që lidhet me pasuritë natyrore dhe monumentet në mbrojtje në të cilat institucionet lokale kanë ndërmarrë veprimet e mundshme për t'i ruajtur e promovuar, kësaj i shtojmë edhe peisazhin e jashtëzakonshëm, vargmalet që qarkojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Ferizajt, me pikë reference fshatin Jezerc, të dëshmuar si një potencial zhvillimor e turistik, pa lënë anash edhe zonat tjera me potencial të jashtëzakonshëm turistik të paraqitura në formën e agroturizmit. Së dyti, pozita e favorshme gjeografike, dinamikat e zhvillimit ekonomik, frekuentimi masiv nga qendra të tjera të afërta brenda dhe jashtë vendit, historia e zhvillimit të qytetit, diversiteti kulturor e etnik, mosha e re e popullatës dhe dallueshmëria mes komunave tjera në fushën e ndërmarrësisë, janë disa nga pikënisjet që reflektojnë potencialin turistik të Komunës së Ferizajt e që suksesshëm i vihen kornizat në këtë Strategji për Zhvillimin e Turizmit për Komunën e Ferizajt në vitet 2023-2027.

Kjo punë, shkrirë në këta rreshta, këto planifikime e orientime profesionale, nuk do të ishin të tilla, pa mbështetjen e ekipeve profesionale, ekspertëve të fushës, prirë nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj – Fakulteti i Turizmit, Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, njohës e vullnetmirë të shumtë, të cilëve i shprehim falënderim të veçantë, që me kontributin e tyre profesional, ideor, sollën këtë dokument përmbajtësor e pikë reference për të gjitha planifikimet e ardhshme në fushën e turizmit në Komunën e Ferizajt.

Me respekt,
Agim Aliu
Kryetar i Komunës së Ferizajt

Përmbledhja ekzekutive

Strategjia e Turizmit paraqet një dokument strategjik të bazuar në planin e veprimit, që ka për synim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim e turizmit për periudhën kohore 2023-2027. Strategjia mbështetet në ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, krijimin e klimës së partneritetit me biznesin, krijimin e mundësive për aktivitete të fushës së turizmit dhe hapësira për grupet e margjinalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për zhvillim të turizmit. Komuna shtron para vetes qëllimet dhe objektivat në të cilat mbështetet në realizimin e kërkesave të qytetarëve, vizitorëve dhe bizneseve për një mirëqenie më të mirë dhe padyshim në përputhje me buxhetin e përcaktuar.

Grupi punues ka përgatitur një raport fillimor dhe një plan të punës për komunën, e cila ka integruar përpjekjet e mëparshme për zhvillimin e turizmit. Komuna deri më tani ka organizuar ekipe të ndryshme të komunitetit të përbërë nga të gjithë personat kyç të qeverisë lokale, të sektorit publik dhe atij privat, e veçanërisht të komunitetit të turizmit, pasi që objektiv e komunës është që planifikimi dhe implementimi i zhvillimit të turizmit të bëhet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, e cila kohëve të fundit ka ndërmarrë hapa konkret për zhvillimin e turizmit, në bashkëpunim me komunitetitn e turizmit dhe shoqërinë civile të organizuar në komunë .

Ekipi ka definuar vizionin e Komunës dhe ka identifikuar strategjitë për zhvillim ekonomik dhe të turizmit. Ky proces do të na shpie tek finalizimi i Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit dhe do të lejojë Komunën për të përcaktuar detyrat dhe aktivitetet për të kompletuar një plan të implementimit.

Në këtë dokument, Komuna ka prezantuar planin e saj për të përkrahur zhvillimin e sektorëve kyç potencial si vijon:

- Turizmi urban, rural dhe malor
- Turizmi kulturor
- Turizmi sportiv dhe rekreativ
- Zhvillimi i turizmit ditor në turizëm me qëndrim më të gjatë në Komunën e Ferizajt

Hyrja dhe sfondi

Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, turizmi si në Kosovë poashtu edhe në Komunën e Ferizajt njohu ritëm zhvillimi të ndjeshëm, duke dhënë shenja që është një sektor me mjaft potencial për vendin. Në periudhën 2017-2019, ardhjet e vizitorëve të huaj të regjistruar në të gjitha pikat kufitare të Kosovës kishin shënuar rritje për 10.7%, nga 4.48 milionë sa ishin në 2017-ën në 4.96 milionë në 2019-ën. Qëllimi i vizitës tek rreth 76% e rasteve në 2019-ën ishte vizita e miqve dhe të afërmve. Ardhjet tjera të evidentuara ishin transitore, me qëllim të pushimit ditor dhe për punë. Sipas origjinës, në 2019-ën dominonin ardhjet nga rajoni, kryesisht nga Serbia (28.2%), Shqipëria (25.6%) dhe Maqedonia Veriore (21.9%), përderisa nga bota dominonin ardhjet nga Gjermania (4.6%) dhe Zvicra (4.2%), vende ku janë të koncentruar diaspora kosovare.[1]

Komuna e Ferizajt ende nuk ka një strategji të saj të turizmit dhe arsyeja e hartimit të strategjisë është përcaktimi i kahjes se ku do të arrij Komuna e Ferizajt në pesë vitet e ardhshme në qëllim të zbatimit të projekteve për zhvillim të turizmit. Deri më tani Komuna e Ferizajt ka zhvilluar disa aktivitete përmes të cilave ka vlerësuar dhe i ka dhënë hapësirë në plane zhvillimore turizmit dhe rëndësinë që ka turizmi në zhvillimin ekonomik të Komunës së Ferizajt. Valorizimi ekonomik i pasurive natyrore, objekteve dhe vlerave tjera në Komunën e Ferizajt është i rëndësishëm për joshjen e vizitorëve vendor dhe të huaj. Duke marrë parasysh orientimet strategjike zhvillimore, Komuna do të bëj përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të turizmit të përmirësoj kualitetin e jetës së qytetarëve, duke krijuar mundësi të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Atraksionet kulturore, historike dhe fetare, shpirti dinamik që e ofron qyteti dhe veçantitë natyrore përreth, e bëjnë atë një nga destinacionet kryesore të turizmit në nivel vendi dhe me një potencial të madh për të gjeneruar interesim shtesë në të ardhmen.

Kjo strategji trajton aspektet e zhvillimit ekonomik të orientuara në drejtim të partneritetit me të gjitha palët e interesit me qëllim të rritjes së punësimit, uljes së nivelit të varfërisë dhe rritjes së cilësisë së jetesës. Për të arritur këto qëllime, Komuna fokus të veçantë duhet t'i jap përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, zhvillimi i sektorit të bujqësisë, nxitjen e krijimit të vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja qoftë nga vendi, e po ashtu edhe nga jashtë.

[1] ASK (2020). Statistikat e Hotelerisë

Strategjia hartohet në përputhje me dokumentet strategjike komunale dhe shtetërore si Planin Strategjik Afat-Mesëm Komunal dhe planin afatgjatë të Qeverisë, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, PZHK- (2017-2025+).

Përmbajtja në vazhdim është siç vijon:

Seksioni 1 - Përfshin përmbajtjen, literaturën dhe anlizën e indikatorëve; Seksioni 2 - Ofron statistika të turizmit në nivel global dhe shpalos trendët kryesorë në këtë nivel; Seksioni 3 - Shpjegon gjithë procesin e hartimit të kësaj strategjie; Seksioni 4 - Rendit një listë potenciale të rrjedhave të vizitorëve dhe përshkruan përzgjedhjen e tyre me prioritet; Seksioni 5 - prezanton analizën e përgjitshme SËOT, ku përfshihen përparësitë dhe dobësitë në njërën anë, si dhe mundësitë dhe kërcënimet në anën tjetër; Seksioni 6 - Ofron një hartëzim ë të gjithë akterëve dhe funksioneve relevante të turizmit në Ferizaj, përfshirë edhe mbështetës aktiv dhe ambientin rregullues; Seksioni 7 - Prezanton një pasqyrë të rrjedhave të përzgjedhura të vizitorëve, duke u fokusuar tek profili, motivi i vizitës, ndikuesit, përparësitë e ofertës si dhe sfidat kryesore; Seksioni 8 - Përshkruan vizionin e përbashkët për zhvillimin e sektorit të turizmit dhe objektivat e përgjithshme; Seksioni 9 - Përfshin veprimet e propozuara për adresim të sfidave dhe nevojave kryesore të turizmit; Seksioni 10 - Prezanton planin e punës. Në fund, Seksioni 11 - Ofron disa indikatorë për matje të zhvillimit të turizmit dhe progresit të përgjithshëm në zbatim të strategjisë, ku mes tjerash, propozohet edhe mekanizmi që garanton zbatimin.

I. Rezultatet e mbledhura nga pasqyra e literaturës, dokumentet programore, planet, strategjitë dhe studimet e tjera të Komunës së Ferizajt

Rezultatet e mbledhura nga pasqyra e literaturës dhe dokumentet planore, strategjia dhe studime të Komunës së Ferizajt duhet të mundësojnë analizën për atë se sa problemet, dukuritë dhe raportet janë trajtuar në opinion dhe në cilën mënyrë janë prezantuar në dokumentacionin. Në këtë pikëpamje nevojitet që të rianalizohet literatura, e cila përfshinë turizmin në Komunën e Ferizajt, masat e ndërmarra në sferën e planifikimit dhe çasjet strategjike.

I.1 Rishkimi i literaturës

Përpilimi i Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit mbështetet në literaturën profesionale në sferën e turizmit dhe zhvillimit hapësinor, në të cilën Komuna e Ferizajt, lokalitetet, objektet, kornizat e saja dhe kushtet e analizuara paraqesin pikën kryesore në kuptimin teorik. Gjeografia turistike në Republikën e Kosovës, rajonet turistike në Kosovë, pasqyra turistike, studime te fizibilitetit të Neredimes dhe Jezercit si dhe literaturë tjetër. Zhvillim i karakteristikave aktuale në turizmin në rajonin e Maleve të Sharrit. Në këtë literaturë janë dhënë pasqyrimet e treguesve më të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në këtë hapësirë dhe mjedisin përreth. Në plan të parë janë shqyrtuar resurset natyrore dhe antropogjenë si komponentë atraktiv, karakteristikat komunikuese, shënimet demografike, zhvillimi socio-ekonomik dhe përcaktim i tyre hapësinor. Ky material jep bazë të mjaftueshme që të mundet të orientohemi kah përcaktimi preliminar i dukurive dhe raporteve në sferën ë turizmit në komunë.

Dokumenti mbulon përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe sinjalizimit, rindërtimin e teleferikut dhe teleferikëve të skijimit , ndërtimin e shtigjeve për këmbësorët dhe të shtigjeve për biçikleta, shtigjet e alpinizmit dhe sinjalizimi i tyre, elektrifikimi, sigurimi i qasjes së ujit të pastër për pije, objekteve të turizmit social, objekteve për manifestimet kulturore, palestrat për të rinjtë dhe rekreacion (fushat sportive, ndërtimi i terreneve të vogla sportive) rregullim urban i objekteve publike në zonat rurale me ngritjen e pajisjeve urbane (ulëse, kosha, ndërtimin alpinetumeve etj).

Turizmi në rajon është ende në një faze fillestare, por ka potencial për t'u zhvilluar në të ardhmen. Rritja e konsiderueshme është parashikuar në lidhje me vizitorët e huaj që vijnë kryesisht nga Shqipëria, Turqia, Gjermania, Austria, vendet skandinave, Britania e Madhe dhe SHBA.

II. Metodologjia

Ky dokument është i domosdoshëm nga ana e administratës lokale në Komunën e Ferizajt që të aplikohet metodologjia e qëndrueshme hulumtuese. Ajo përfshin format dhe përmbajtjet të cilat i përgjigjen nevojave të kësaj tërësie hapësinore dhe në atë drejtim të kenë karakter të pranueshëm dhe përgjegjës. Në përpunimin e strategjisë për zhvillim të turizmit në Komunën e Ferizajt hulumtimi i përfshin këta komponentë:

- Hulumtimi në funksion të përpilimit të Strategjisë për Zhvillim të Turizmit në Komunën e Ferizajt mbështetet në treguesit sekondar me çka janë shfrytëzuar indikatorët relevant, të cilët janë publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës në sferën e kësaj veprimtarie, si dhe treguesit të cilët janë të pranishëm në buletinet, raportet dhe publikimet tjera të nivelit rajonal, nacional dhe lokal.

Përkundër studimeve sekondare, është e domosdoshme që të kryhet involvim ose qasje e cila do të mundësojë shqyrtimin e qëndrimeve dhe mendimeve të njohësve të mundësive të cilët në fakt janë përfaqësues eminent në palët e interesuara. Në bazë të të dhënave të fituara nga rezultatet e grumbulluara mundësohet shqyrtimi i problemeve aktuale në këtë sferë në Komunën e Ferizajt.

Ndaj të dhënave statistikore janë kryer analiza statistikore me përdorimin e teknikave të ndryshme si: analiza deskriptive, analiza e variacionit, analiza e serive kohore, analiza e indeksit dhe parashikimit të vlerave të ardhshme.

Në bazë të dukurive të konstatuara dhe marrëdhëniet në sferën e zhvillimit të turizmit, si dhe sipas rezultateve nga analizat vjen deri te definimi i misionit dhe vizioni i strategjisë. Kjo qasje analitike preliminare mundëson që të konstatohen caqet e përgjithshme dhe të veçanta në zhvillimin e turizmit në këtë hapësirë.

Në funksion të klasifikimit të resurseve turistike në Komunën e Ferizajt dhe krijimi i hartave të tyre kemi edhe përcaktimin e vlerave, respektivisht prioritetet e kultivimit të vlerave të pozitës hapësinore dhe lidhjeve komunikuese, resurseve natyrore dhe antropogjene, kushteve të përgjithshme, resurseve receptive, formave selektive të turizmit dhe implikimet financiare.

Metodologjia është adaptuar, fillimisht për t'iu përshtatur kontekstit dhe veçorive të vendit, si dhe për të qenë në harmoni me dokumentet ligjore për hartim të dokumenteve strategjike, përkatësisht me "Udhëzimin administrativ 07/18 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit", "Manualin për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit" dhe me "Rregulloren (QRK) 05/2016

për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Për zhvillimin më gjithëpërfshirës të kësaj strategjie është formuar grupi punues.

Grupi punues i themeluar për hartimin e kësaj strategjie përfshinë anëtarët nga:

1. Kuvendi Komunal i Ferizajt
2. Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës
3. Universiteti i Shkencave Hoteliere dhe Turistike
4. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
5. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
6. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
7. Drejtoria e Arsimit
8. Oda e Hotelerisë dhe Turizmit – Rajoni i Ferizajt
9. Federata Alpiniste Bjeshkatare
10. Grupi i profesionistëve.

Realizimi i këtij raporti fillestar është kryer përmes disa fazave:

Më poshtë janë përshkruar hapat kryesor gjatë procesit të hartimit të strategjisë, nga fillimi deri në përfundim.

Tabela 8: Hapat kryesor gjatë hartimit të strategjisë

Përzgjedhja e rrjedhave strategjike të vizitorëve	Fillimisht, grupi punues, që përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të nivelit komunal dhe nga organizatat e shoqërisë civile, kanë punuar në përgatitjen e një liste të gjerë të rrjedhave të vizitorëve. Bazuar në vlerësimet sasiore dhe në diskutimet e natyrës cilësore të zhvilluara nga grupi punues, është bërë prioretizimi i rrjedhave të cilat demonstrojnë potencial më të madh ekonomik, si dhe potencial për zhvillim të qëndrueshëm.
Punëtoria dhe fokus grupet	Më pas, është organizuar një punëtori fillestare me pjesëmarrës të ndryshëm nga industria e turizmit (përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues të OJQ-ve, tur-operatorë dhe akterë tjerë të sektorit privat) me qëllim të informimit të tyre mbi metodologjinë dhe procesin. Si vazhdim i kësaj punëtorie, janë organizuar fokus grupe tematike për mbledhje të të dhënave.
Takimet individuale me njohës të turizmit	Pas analizës së të dhënave të mbledhura gjatë fokus grupeve, janë realizuar takime individuale me njohës të turizmit, shumica nga sektori privat, për t'i verifikuar dhe plotësuar më tutje të dhënat e mbledhura, si dhe për të diskutuar mbi orientimet strategjike dhe veprimet e nevojshme.
Punëtoria me grupin punues	Më tutje, është organizuar edhe një punëtori me grupin punues, ku bazuar në të dhënat e mbledhura dhe praktikat e mira të vendeve tjera, janë draftuar objektivat dhe veprimet e strategjisë, si dhe janë harmonizuar ato me dokumentet tjera planifikuese. Njëkohësisht, është përpiluar edhe plani i veprimit. Në këtë fazë, kemi organizuar punëtori me bizneset hoteliere dhe turizmit, gastronomisë, qyetarët dhe kryetarët e fshatrave, me studentët e drejtimeve të turizmit dhe të ngjashme, si dhe është ofruar ndihmë edhe nga ekspertë të vendor me theks të veçantë nga OHTK-ja dhe UShAF-i.
Konsultimet publike	Në fund, draft-strategjia është ndarë me të gjitha palët dhe para se të finalizohet, drafti është dërguar ne konsultim paraprak dhe janë organizuar konsultime publike për të pranuar opinione shtesë dhe për t'u siguruar që strategjia është konform pritjeve të publikut të gjerë.

Tabela 1 – Punëtoria e parë të gjeturat-analiza e faktorëve-Komuna e Ferizajt

III. Misioni

Misioni i Strategjisë së Turizmit të Ferizajt është rritja e numrit te vizitorëve dhe invistorëve, zhvillimi i destinacioneve, zonave, produkteve dhe shumëllojshmëria e ofertës turistike, rritja e vlerës së shtuar të turizmi në Komunën e Ferizajt, e në veçanti " Bifukacioni i Neredimes".

IV. Vizioni

Vizioni: Ferizaj qytet i zhvillimit ekonomik, dinamikës tregtare, argëtimit dhe rekreacionit.

V. Analiza e gjendjes së turizmit në Komunën e Ferizajt

Analiza e gjendjes i përfshin parametrat që kanë karakter konstant dhe dinamik. Ajo i referohet vendit dhe rolit që në këtë moment e ka turizmi në Komunën e Ferizajt në aspektin e treguesve hapësinor, potencialeve turistike si bazë burimore, vëllim, strukturë dhe dinamikë e veprimtarisë turistike dhe hoteliere-turistike, organizimi dhe rregullimi i veprimtarisë, niveli i mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe përfshirja e tij në aktivitetet turistike, qarkullimin turistik me theks të veçantë të receptivit të hapësirës, tregje të caktuara turistike, dhe karakteristikat e produkteve turistike si pjesë e ofertës turistike.

V.1 Historiku i Ferizajt

Ferizaj është qytet i ri, por rrethina e tij ka qenë e banuar që nga mijëvjeçari VI p.e.s. Nga gjetjet arkeologjike në fshatin Varosh, 3 km në jug të Ferizajt, dëshmojnë se këto anë kishte një qytetërim që në kohën e neolitit të hershëm. Kështu që nga shekulli VIII para Krishtit e deri në pushtimin romak, Ferizaj dhe rrethina e tij u banua nga popullata dardane. Tumat varrore dardane janë gjetur në Rajonin e Ferizajt, në Gërlicë (Gurëz) gjithsej 18 varreza i përkasin shekujve VIII-VII dhe më pas nekropolet tumulare në Zaskok.

Në vitin 96 para Krishtit, Dardania pushtohet nga Perandoria Romake, prandaj edhe rrethina e Ferizajt, bie nën sundimin romak.

Nga shekulli IV pas Krishtit e deri në në shekullin XV, rrethina e Ferizajt u sundua nga Perandoria Bizantine, më pas nga bullgarët dhe serbët. Kurse pas shekullit XV deri në vitin 1912, kjo trevë dhe i gjithë ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Historianët besojnë se gjatë këtyre shekujve, një substrat ilir i cili deri në shekullin XVIII njihej si arbër, pastaj u quajtën shqiptarë.

Ferizaj zë fill më 1873 me ndërtimin e hekurudhës Mitrovicë – Shkup. Në pjesën e dytë të shekullit XIX udhëpërshkruesit flasin për një han të Feriz bej Shasivarit, sipas të cilit e

mori emrin ky vendbanim, që brenda pak dekadash u bë qytet, i populluar kryesisht nga tregtarë e zejtarë. Piktura e Hanit të Feriz Beut është pjesë e emblemës së Komunës së Ferizajt.

Si emër i parë i vendbanimit të ri ishte i emërtuar në shënimet e kohës si Ferizoviq, që nga viti 1874, krahas këtij emri që ishte emërtuar nga autoritetet e kohës ishte në përdorim edhe emri Tasjan, që nga gjuha frënge kemi të bëjmë me stacion, kurse emri Ferizaj, lidhet me emrin e hanxhiut Feriz Shashivarit, por pas pushtimit serb të Ferizajt, do të kemi ndryshimet në toponominë e emrave nga ata shqiptarë në emërtimin serb Urośevac(pas vitit 1914).


Më 12 qershor 1999, në Ferizaj hynë forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të NATO-s, duke i dhënë fund sundimit 87-vjeçar serb. Në luftimet ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe gjatë viteve 1998 – 1999, dhjetëra civilë shqiptarë u vranë, ndërsa u dogjën mijëra shtëpi. Mbi gjysma e popullatës shqiptare të Ferizajt ishte dëbuar jashtë Kosovës nga regjimi serb i Milosheviçit.

V. 2 Pozita gjeografike e Ferizajt

Ferizaj shtrihet në pjesën jugore të rrafshit të Kosovës dhe në pjesën veri-lindore të maleve të Sharrit saktësisht në koordinatat gjeografike 42,36825˚ Veri, 21,15336˚ Lindje. Komuna e Ferizajt ka një hapësirë prej 345 km² me 108.690 banorë (regjistrimi i popullsisë 2011) ku gjysma e këtyre banorëve jetojnë në 45 fshatrat e saj. Komuna e Ferizajt në lindje kufizohet me Komunën e Gjilanit dhe të Vitisë, nga të cilat qendra ka distancën rrugore prej 32 km, përkatësisht 21 km. Në jug kufizohet me Komunën e Kaçanikut (16 km), në jugperëndim me Shtërpcën (32 km), në perëndim me Prizrenin (60 km) e Therandën (42 km) dhe në veri me Shtimen (13km) e Lipjanin (17km). Distanca e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km.

Qyteti i Ferizajt ka pozitë qendrore karshi territorit të komunës, ku lartësia mbidetare e qytetit është rreth 580 metra mbi nivelin e detit.

Ferizaj është qyteti me i ri në Kosovë, i cili ka një pozitë shumë të mirë gjeografike pasi që shtrihet në pjesën ku janë prerë rrugët e vjetra Prizren-Anamoravë dhe rruga tjetër Prishtinë – Shkup, por më së shumti hov dhe zhvillim qytetit i dha shtrirja e hekurudhës Mitrovicë-Ferizaj-Maqedoni e përmes shteteve fqinje edhe me shtete tjera. Këto rrugë të vjetra sot janë arteriet kryesore në Kosovë.



Harta 1. Pozita gjeografike e komunës, qytetit dhe qendrës së qytetit[2]

V.3 Relievi i Ferizajt

Qyteti i Ferizajt shtrihet në jug te rrafshit të Kosovës, respektivisht aty ku thyhet pllaka e rrafshit të Kosovës, e ku ndan ujin në dy ujëndarës. Kah jugu ujëmbledhësi i Detit Egje dhe kah veriu ujëmbledhësi i Detit të Zi. Qyteti ka lartësi mbidetare rreth 580 metra mbi nivelin e detit dhe ka një reliev te rrafshët, e po ashtu edhe shumica nga fshatrat e Ferizajt kanë reliev të rrafshët.

Relievi në qytet është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e jetës për shkak se nga relievi janë të varura shumë punë infrastrukturore. Veçanërisht është e lidhur me format e transportit, andaj relievi i rrafshët në qytet mundëson një planifikim dhe zhvillim shumë të mirë të infrastrukturës për transport dhe mobilitetit fleksibil të njerëzve, me të gjitha mjetet e transportit, e sidomos tek ata njerëz që përdorin biçikletën dhe ecjen në këmbë, e kjo është edhe njëra ndër përparësitë kryesore që e ka qyteti.

Relievi i rrafshët mundëson mirëmbajtjen më të lehtë gjatë stinëve të dimrit, shpenzime dhe ndotje më të vogël të ajrit nga automjetet, zhvillim të transportit hekurudhor.

[2](A.Hashani)

V.4 Klima në komunën dhe qytetin e Ferizajt

Ferizaj karakterizohet me klimë kontinentale, si edhe pjesa më e madhe e Rrafshit të Kosovës. Temperatura vjetore mesatare është 9.9°C. Muajt më të ngrohtë janë korriku dhe gushti, me temperaturë mesatare 18.9°C. Muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare -2.6°C. Temperatura maksimale e ajrit është 32.5°C në korrik, ndërsa ajo minimale -14.0°C. (Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt 2008).

Tabela Nr.11. Temperatura mesatare e muajit gjatë vitit

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	mes
-2.6	o.3	4.3	10.1	14.5	18.5	20.6	20.5	16.4	10.6	6.o	1.5	10.2

Burimi: Stacioni hidrometerologjik i Ferizajt


V.5 Infrastrktura rrugore në Ferizaj dhe banimi (rrugët, trotuaret, parkingjet, shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive)

Infrastruktura fizike e mobilitetit në Ferizaj ka një shtrirje të zakonshme sikur në të gjitha qytetet e Kosovës. Përveç rrugëve kryesore pjesën tjetër të rrugëve të pa planifikuara dhe të ndërtuara në bazë të kushteve dhe nevojave të kohës.

V.6 Rrugët

Rrugët. Duke shikuar hartën vërejmë se lidhjet dhe rrjeti rrugor në Komunën e Ferizajt është mjaft i mirë, po ashtu edhe brenda qytetit kemi një rrjet rrugor shumë mirë te lidhur me qendrën e qytetit qe është pozitive, gjithashtu projektet e fundit brenda qytetit kanë lehtësuar komunikacionin.

Ferizaj ka lidhje shumë të mirë në arterien kryesore të Kosovës, në drejtimin veri-jug, magjistralja N2/E65, e cila e lidh Prishtinën me Shkupin, si dhe në drejtimin lindje-perëndim, magjistralja N25-3, e cila lidh Ferizajn me Gjilanin dhe Prizrenin. Ferizaj ka gjithashtu lidhje të mira me Shtërpcën – Brezovicën ose Prevallën, Tetovën. Kurse, përmes Shtimes lidhet me Prizrenin ose me autostradën Nish-Durrës.



V.7 Trotuaret

Një ndër çështjet me të rëndësishme në infrastrukturën fizike të mobilitetit janë trotuaret, pasiqë në to lëvizin të gjithë njerëzit për aktivitetet e tyre ditore. Pjesa ma e madhe e rrugëve kryesore dhe rrugëve të reja kanë trotuar të mjaftueshëm dhe kjo është shumë e rëndësishme për banorët, pasi që ne edhe po synojmë që në të ardhmen të bëjmë politika për të nxitur njerëzit për të ecur. Për ta arritur ketë qëllim, natyrisht që përveç hapësirës së mjaftueshme për trotuar, është e rëndësishme standardet tjera teknike urbane siç janë: ndërtimi, dizajni, ndriçimi dhe mirëmbajtja e tyre.

V.8 Parkingjet

Parkingjet: Sfidat e infrastrukturës rrugore në Ferizaj çdo ditë po shtohen si pasojë e rritjes se pronarëve të automjeteve dhe përdorimit të tyre, ku një rol shumë të rëndësishëm ka sigurimi i parkingjeve për automjete. Parkingjet sot janë një ndër sfidat kryesore në qytet e sidomos në qendër.

Vërehet mungesë e parkingjeve, e si rezultat kemi parkingje jo të rregullta, ku kjo po i sjell shumë probleme lëvizjes së lirë.

V.9 Popullsia –shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive

Ferizaj është qyteti më i ri në Kosovë, historia e tij lidhet me hekurudhën. Vija hekurudhore ushtroj influencë pozitive për lindjen dhe ngjalljen e procesit shoqëror ekonomik. Për shkak rëndësisë historike të hekurudhës, stacioni hekurudhor duhet të ruhet të restaurohet si një pikë historike e turistike.

Për shkak zhvillimit të shpejt ekonomik migrimi ishte shumë i madh dhe të gjitha këto përpjekje dhe plane nuk munden t'i bënin ballë migrimeve të shpejta drejt Ferizajt. Andaj, u krijuan lagje

banimi pa plan, pa infrastrukturë përcjellëse ku edhe sot ka pasoja, siç janë rrugët e ngushta dhe pa dalje, mirëpo në vitet e fundit janë përmirësuar duke asfaltuar e duke krijuar infrastrukturën përcjellëse.

Kjo dinamikë e madhe e popullsisë dhe ekonomisë ka bërë që qyteti të ketë një ngarkesë të madhe në komunikacion, pasi që përveç banorëve urban qyteti gjeneron dhe thith shumë banorë nga komuna, rajoni dhe nënrajonet tjera të Kosovës.

V.10 Karakteristikat ekonomike të qytetit (primar, sekondar, terciar)

Nëse shikojmë historinë e Ferizajt shohim se krijimi i qytetit është ngushtë i lidhur me aktivitetet e hershme ekonomike.

Kryqëzimi i rrugëve të vjetra Prishtinë-Shkup dhe Anamoravë – Prizren e veçanërisht shtrirja e hekurudhës dhe ndërtimi i stacionit hekurudhor në këtë lokacion kanë qenë faktori kryesor i lindjes së tregtisë, prodhimit dhe shërbimeve të ndryshme zejtare ku kanë nxitur krijimin e lokalitetit që shpejt është krijuar Qytet. Vlen të ceket se Ferizaj në vitin 1900 kishte 400 shtëpi dhe 200 lokale. Ky numri i madh i lokaleve flet për një dinamikë të madhe ekonomike me një ofertë tregtare jo vetëm për qytetin dhe fshatrat përreth, por ishte një treg ndër rajonal, që fatmirësisht e ka edhe në ditët e sotit.

Në kuptimin ekonomik, Ferizaj funksionon si një treg i madh ku për veç banorëve lokal kemi edhe shumë udhëtarë ndër rajonal poashtu edhe nga qytetet jashtë Kosovës, që vijnë dhe marrin shërbime të ndryshme ekonomike.

Agjensioni Statistikor i Kosovës, Ferizajn e rendit si komuna e dytë me zhvillim ekonomik në Kosovë, pas Prishtinës. Ky zhvillim ekonomik është falë pozitës së mirë gjeografike. Zhvillimi i tillë ekonomik e bën Ferizajn një vend atraktiv për biznese e njëherit shumë dinamik me një mobilitet të madh të njerëzve.

Numri i bizneseve të regjistruara në Ferizaj është shumë i madh. Në sektorin primar rajoni i Ferizajt nuk është i njohur si prodhues bujqësor e blegtoral krahasuar me komunat tjera edhe pse vitet e fundit me vetiniciativë dhe ndihmën nga shteti dhe organizata ndërkombëtare ka filluar mjaft mirë zhvillimi bujqësor. Kjo do të ndihmonte edhe turizmin agrar në të ardhmen.

Sektori i dytë industria në vitet e mëhershme në Ferizaj ishte shumë e zhvilluar, e cila tërhoqi edhe shumë migrues për të jetuar në qytet.

Kjo industri në vazhdën e privatizimit e humbi primatin që kishte. Sot, industria është e organizuar në sektorin privat ku kemi një numër të madh ndërmarrjesh përpunuese, sidomos në sektorin e përpunimit të drurit.

Sektori me i rëndësishëm për Kosovën e veçanërisht për Ferizajn pa dyshim është sektori i tretë për shkak të mungesës së alternativës prodhuese, qytetaret detyrimisht janë orientuar në shërbime dhe tregti, rekreacion e gastronomi.

Komuniteti i biznesit përbëhet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ekonomitë familjare kryesisht në lëminë e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë, bujqësisë, ndërtimtarisë dhe të zejeve të tjera.

- Biznese prodhuese 11 % +
- Biznese tregtare 45 %
- Biznese shërbyese 44 % (PZHU)

V.11 Karakteristikat sociale të qytetit (arsimi, shëndetësia, shërbimet, kutlura, feja)

Qyteti i Ferizajt është zgjeruar në disa faza, të cilat janë të lidhura me ngjarje historike dhe ekonomike.

Faza e parë konsiderohet faza nga fillimi i krijimi i vendbanimit më **1873** deri në pushtimin serb 1912. Karakteristikë e kësaj faze është se vendbanimi ishte kryesisht i shtrirë rreth hekurudhës dhe disa lagjeve të veçanta si lagjja e Muhagjerëve[3], lagjja e romëve.

Arsimi: Gjatë viteve të para të vendbanimit nuk ka pasur shkolla, por rolin e tyre e kanë luajtur mejtepet, të cilat kanë qenë aktive dhe primare deri në pushtimin serb të Kosovës në fund të vitit 1912. Pas kësaj periudhe deri në Luftën e Dytë Botërore kanë qenë disa shkolla fillore ku mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Shpërndarja e këtyre shkollave ka qenë jo vetëm në Ferizaj por edhe në rrethinë.

Shkolla e parë në gjuhën shqipe në Ferizaj është hapur më 27.XI.1941/42 me iniciativën e z. Shaban Shaqir Vatës që konsiderohet si pishtari i arsimit në Ferizaj (Ibrahim Hyseni, "Ferizaj 1873-1944"). Kontribut të madh në hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe kanë dhënë mësuesit e ardhur nga Shqipëria në vitin 1941 dhe ndryshe quhet periudha e Ernest Koliqit, i cili solli mbi 240 mësues për t'i hapur shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Kosovë.

Sot, Ferizaj me rrethinë numëron 37 shkolla amë fillore dhe 8 shkolla të mesme dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara. Kolegji privat "Universum", Kolegji AAB dhe Kolegji "UBT" që tërheqin një numër të madh të nxënsve dhe studentëve nga komunat tjera jashtë Ferizajt.

[3]Banorë të ardhur kryesisht prej rrethit të Nishit dhe më gjerë pas vitit 1878

V.12 Shëndetësia

Shëndetësia: Shëndetësia publike e Ferizajt organizohet në të tri nivelet shëndetësore: Kujdesi Primar Shëndetësor (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Qendra e Shëndetit Mendor në Komunitet), Kujdesi Sekondar Shëndetësor (Spitali Regjional) dhe Kujdesi Tretësor Shëndetësor (Instituti Regjional për Shëndet Publik). Këto qendra shëndetësore disponojnë me punonjës lëmenjsh të ndryshëm të sistemuar në katër Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 14 punkte shëndetësore në nivel fshatrash. (Udhërrëfyesi komunal) . Gjithashtu vlen te ceket se në Ferizaj ekzistojnë një numër i madh i ordinancave dhe laboratorëve privat që ofrojnë shërbime mjekësore.

Organizimi shëndetësor në tri nivele ka bërë që Ferizaj të jetë qendër tërheqëse për komunat që janë ndër nivelin regjional, e të cilët banorë e shtojnë numrin e lëvizjeve në qytet. Sa i përket qendrave kryesore familjare kanë një shpërndarje të mirë në qytet pasi që gjenden në pjesët periferike të qytetit, e të cilat qendra mundësojnë qytetarëve që të marrin shërbime më të shpejta pa pasur nevojë për të hyrë në qendër.

V.13 Shërbimet

Shërbimet: Shërbimet në Ferizaj janë të ndryshme dhe të shumta pasi që Ferizaj është qendër regjionale. Shërbimet publike kanë një shtrirje të centralizuar.

Po ashtu edhe shërbimet tjera publike janë të centralizuara në qendër. Vlen të ceket se dy prej kompanive publike që menaxhojnë me ujin dhe mbeturinat, kanë filluar ta hapin pika të reja në pjesë të ndryshme të qytetit.

Shërbimet e sigurisë siç janë Policia dhe Zjarrfikësit janë të centralizuara dhe shpeshherë nuk mund të kryen shërbim cilësor dhe të shpejt tek qytetarët.

Kurse, kompanitë tjera ekonomike si PTK, IPKO, dhe Bankat kanë një decentralizim të mirë dhe efikas. Ky do të ishte shembulli më i mirë për të kuptuar se decentralizimi do lehtësonte punën e stafit në qendër si edhe do ta lehtësonte komunikacionin në qendër.

V.14 Kultura

Kultura: Objektet kulturore në Ferizaj vitet e fundit kanë aktivitete edhe ndërkombëtare që tërheqin vizitorë. Ferizaj ka një Qendër Kulture, Teatër, Galerinë e Arteve, Muzeun e Qytetit dhe dy Biblioteka ku të gjitha janë të shtrira përgjatë rrugës së qendrës së qytetit. Vlen të cekën "Festivali i Teatrove", "Festivali i Filmit", "MuralFest" etj, që nëse do të ju jepet përkrahje ekonomike e ideore do të rriteshin dhe do të ndërkombëtarizoheshin këto aktivitete kulturore.

V.15 Objektet e kultitit apo fesë

Objektet e kultit apo fesë: Tërheqin mjaft vizitorë e sidomos Xhamia dhe Kisha Ortodokse në të njëjtin oborr (pavarësisht rrethanave historike të ndërtimit) janë interesante dhe pothuajse se unike.

V.16 Shfrytëzimi i mjeteve motorike (kolektive, individuale)

Shfrytëzimi i mjeteve motorike si në të gjithë botën ashtu edhe në Kosovë respektivisht në Ferizaj është jashtëzakonisht i madh. Natyrisht që transporti e veçanërisht mjetet motorike janë të domosdoshme për zhvillimin e turizmit edhe ekonomisë të një vendi, për shkak se lëvizja e njerëzve për të punuar, studiuar apo për t'u argëtuar është nga karakteristikat themelore të jetës moderne.

Integrimi i tregjeve brenda vendit, rritja e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurat më të shumta kanë kontribuar edhe në rritjen e turizmit e që shton nevojën edhe të transportit, e që është mjaft sfiduese. Andaj duhet menduar, përmirësuar e menaxhuar mirë transporti dhe parkingjet që të ketë sa më shumë vizitorë.

Në bazë të statistikave dhe hulumtimeve që janë bërë është gjetur se Ferizaj është një zonë e madhe gjeneruese dhe tërheqëse e trafikut në krahasim me qytetet tjera.

V.17 Shfrytëzimi i mjeteve pa motor (ecje, çiklizëm, etj)

Rëndësia e qyteteve si hapësirë e jetesës për njerëzit është në rritje. Më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton sot në qytete. Qytetet janë motori i zhvillimit ekonomik dhe social. Ato janë gjithashtu vendet ku sfidat ekologjike dhe shoqërore të shekullit të XXI-të janë të theksuara në veçanti. Pjesë nga këto sfida përveç akseve të lëvizshmërisë motorike, rëndësi të veçantë ka edhe pjesët e lira si trotuaret dhe sheshet për këmbësorë. Këto pjesë janë në dispozicion për të gjithë, miqësore për mjedisin dhe frymëmarrje për qytetin.

Të dhënat në disa vende tregojnë se përmirësimi dhe zgjerimi i trotuareve ka nxitur ecjen e udhëtarëve.

Sot në Kosovë respektivisht në Ferizaj gjendje e trotuareve ka nevojë për akoma investime. Në disa nga rrugët nuk ka trotuare, nuk kanë ndriçim, janë të bllokuar nga makinat dhe shitësit e bizneseve etj. Të gjithë këta faktorë mund të jenë arsye të forta që banorët rezidentë brenda qytetit më shumë të përdorin mjetet motorike për udhëtim se sa ecjen në këmbë.

Në bazë të anketës dhe analizave që janë bërë, është konstatuar se shfrytëzimi i mjeteve pa motor është jashtëzakonisht i vogël në Ferizaj krahasuar me mjetet motorike.

Si shtesë e kësaj planifikuesit e mobilitetit urban gjithashtu dizajnojnë korridore të veçanta për llojet e buta të transportit ose dhe transport kolektiv (Mobkos)[4]

Kategorizimi i rrugëve na obligon për të menduar dhe shtruar pyetje në lidhje me rrjetin rrugor. Për kënd po e ndërtojmë këtë rrugë? Sa ka trafik? Çfarë lloji i trafikut zhvillohet? Cilat forma të transportit? Prioritetet për shpejtësi? Siguria? Besueshmëria? Transporti Publik? Këmbësorët? Turistët? Etj

V.18 Transporti hekurudhor

Linja kryesore e hekurudhës në Kosovë kalon nga Shkupi për në Mitrovicë, përmes qytetit të Ferizajt. Në njërën anë, hekurudha dhe stacioni kryesor në qendër të qytetit janë parë si lidhje me pjesën më të madhe të Kosovës dhe si veçori karakteristike për Ferizajn.

Në anën tjetër, hekurudha është një barrierë përmes qytetit, e cila dalëngadalë po ndryshon e po përmirësohet.

Linja hekurudhore ekzistuese përmes qytetit është riparuar, udhëkryqet janë përmirësuar. Stacioni kryesor është ende në qendër të qytetit të Ferizajt, e të cilin në të ardhmen mund të shfrytëzohet shumë mirë në lidhjen e qytetit me vendet tjera.

[4] Urban mobility in Kosovo

VI Turizmi dhe trashëgimia kulturore

Ferizaj si qytet është i ri, por rrethina e tij ka qenë e banuar që nga kohët e lashta dhe për këtë ka dëshmi e gjetje të shumta, të cilat, për shkak të mungesës së mjeteve materiale dhe për shkak të injorimit të kulturës së kësaj treve nga pushtetet e mëhershme, nuk kanë mundur të hulumtohen e të trajtohen aq sa duhet nga ana e shkencëtarëve. Megjithatë, hulumtime të herë pas hershme janë bërë, si në Varosh, Komogllavë, Jezerc, Neredime e vende të tjera dhe nga arkeologë e etnografë është thënë se rrethina e Ferizajt ka një potencial të madh të objekteve me vlerë nga lashtësia.

Ndër këto duhet veçuar Kishën Dardane në malet midis fshatrave Komogllavë, Sojevë e Fshat i Vjetër. Ujësjellësi i kohës Ilire-Romake në fshatin Komogllavë, që furnizon me ujë të pijes edhe sot disa familje. Tumat (varrezat) Ilire në fshatin Varosh. Mbetjet e qytetit të vjetër në Jezerc, gërmadha të kohëve të ndryshme në Neredime etj.

Ferizaj ka këto objekte dhe institucione kulturore: Qendrën e Kulturës, godinë e ngritur më 1924, një nga objektet më të vjetra në qytet; Bibliotekën Publike të Qytetit ”Sadik Tafarshiku”, godinë e ngritur më 1928 dhe shtatë bibliotekat nëpër fshatra; Bibliotekën Ndërkomunale “Anton Çetta” në qytet; Teatrin Profesional “Adriana Abdullahu”; Galerinë e Arteve; Kinemanë e Qytetit; Arkivin Historik të Qytetit; Mullirin e Nikës, ende në funksion, që nga viti 1321 etj.

VI.1 Stacioni i Trenit

Stacioni i Trenit një ndër faktorët më të rëndësishëm nga e kaluara historike për formimin e qytetit të Ferizajt dhe të zhvillimit ekonomik të tij, është padyshim ndërtimi i vijës hekurudhore në vitin 1873 dhe stacionit hekurudhor, linjë kjo shumë e rëndësishme për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, që njëkohësisht ndikoi shumë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimit shndërruar atë në qytet.

VI. 2 Biblioteka publike “Sadik Tafarshiku”

Ky objekt me një arkitekturë të rrallë u themelua në vitin 1873 dhe konsiderohet si objekti më i vjetër i qytetit të Ferizajt. Përkon me themelimin e qytetit të Ferizajt. Kjo bibliotekë dikur kishte shërbyer si objekt komune për qytetin e Ferizajt, më pas edhe si burg, por vlen të ceket se pas mbarimit të luftës ajo u shndërrua në tempullin e dijes duke marrë edhe emrin e Sadik Tafarshikut, njeriut që shpërndau librin në kohë të vështira.

VI.3 Xhamia dhe Kisha në një oborr

Xhamia e madhe, e njohur edhe si Xhamia e Mulla Veselit është ndërtuar në vitin 1891 dhe është restauruar në mes vitit 1942-43 dhe në vitin 1957 është bërë ngritja e minares. Në vitin 2003 është bërë zgjerimi i Xhamisë dhe ndërtimi i shatërvanit. Në vitin 2006 është ngritur edhe minarja e dytë. Kisha Pravosllave serbe apo Kisha e Shën Uroshit u projektua nga arkitekti Josif Mihajlloviqdhe ku u ndërtua në oborr të Xhamisë gjatë viteve 1929-1933.

VI.4 Ish-Gjimnazi "Ismail Qemali"

Ish- Gjimnazi "Ismail Qemali është ndërtuar në vitin 1928. Në këtë shkollë kanë mësuar nxënës të komuniteteve që jetojnë në Komunën e Ferizajt qoftë ata shqiptarë, serb, rom, ashkalinjë, etj. Objekti është në gjendje të mirë, mirëpo aktualisht nuk është në shfrytëzim. Në oborrin e kësaj shkolle në vitin 1991 regjimi i asaj kohe ka ndërtuar një ndërtesë disa katëshe të cilën nuk arriti ta finalizoj.

VI.5 Ish-konvikti për studentë

Ish-Konvikti për studentë është ndërtuar në vitin 1930 dhe deri në përfundim të viteve 1991-92 ka shërbyer si shkollë fillore. Pas përfundimit të luftës, prapë kjo shkollë u shndërrua në një objekt edukimi, për profesione adekuate profesionale në fushën e ndërtimtarisë. Nga viti 2012, kjo ndërtesë është në shfrytëzim të disa organizatave e shoqatave të ndryshme, si shoqata e të verbërve.

VI.6 Teatri i Qytetit

Teatri i qytetit është ndërtuar gjatë viteve 1924-1928 dhe është përdorur për nevoja të ndryshme, fillimisht nga shoqata e gjuetarëve dhe në mes të dy luftërave botërore për nevoja teatrale, aktivitete kulturore të organizuar nga Shoqëritë Kulturore Artistike, kryesuar nga Lorenc Antoni. Në luftën e viteve 1998-1999, ndërtesa ishte i dëmtuar në masë të madhe dhe tani shfrytëzohet për shfaqje teatrale dhe festivalin tradicional të teatrove profesionale.

VI.7 Mulliri i Nikës

Sa i përket Mullirit të Nikës, i cili është i mbrojtur me ligj gjendet në Ferizaj në perëndim të qytetit, afër me fenomenin natyror të Bifurkacionit. Mulliri i Nikës shumë më herët ishte i propozuar për mbrojtje, por në fakt vetëm pas lufte ka hyrë nën mbrojtje, por territori i saj është prekur, pasi nuk është respektuar perimetri i paraparë me ligj. Është restauruar për tre herë duke u munduar që mos t'i humbet pamja dhe të ndryshohet asgjë nga ndërtimi i mëparshëm.

VI. 8 Bifurkacioni

Bifurkacioni është degëzimi i ujit, i vetmi në Evropë dhe i dyti në botë me atë të shtetit të Kolorados të Shteteve të Bashkuar të Amerikës. Sa i përket këtij fenomeni natyror, deri më tani edhe nuk janë marrë shumë seriozisht me këtë çështje, por viteve të fundit ka filluar një përkujdesje më e veçantë dhe ka filluar mirëmbajtja. Vlen të cekët se në vitin 2012 nga Komisioni Evropian i cili vepron në këtë pjesë është bërë rregullimi i shtratit dhe rregullimi i trotuarit për vizitorë.

VI.9 Xhamia e Berishëve

Xhamia gjendet në lagjen e Berishëve të Gremes, e cila sipas banorëve i përket shekullit XV. Kjo xhami ka shërbyer edhe si strehë për shumë kohë edhe e luftërave që kanë vepruar në këto anë, e sidomos në luftën e fundit të vitit 1998-99 ku ishte në shërbim të UÇK-së. Duke parë të nevojshme ndërhyrjet emergjente, QRTK-ja në Ferizaj, me nismën e disa banorëve dhe me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës është bërë edhe restaurimi i fazës së parë me datën 10.06.2012.

VI.10 Mulliri i Selman Begës

Mulliri i Selman Begës është restarurar edhe është i gatshëm për vizitorë, por e vërteta është se para se të ndërtohej ose më mirë të thuhet të rindërtohet nuk është plotësuar me dokumente dhe përpilim të historikut. Kështu që ndoshta në një të ardhme duhet edhe të bëhet një hulumtim, sepse edhe dokumenti i cili është përshkruar lidhur me mullirin në fjalë nuk përshkruan asgjë sa i përket rëndësisë dhe vlerave që ka, për këtë mendojmë se është dashur të jetë një fotografi më e hershme për mullirin.

VI.11 Shtëpia - Kullë e Hasan Fazlisë

Shtëpia e z. Hasan Fazlia nga Kosharja me gurë dhe qerpiç të lidhur në mese edhe me drunj, paraqet traditën e ndërtimit e shekullit XIX. Shtëpia është rreth 150 vjet, më e vjetra në Komunën e Ferizajt dhe të Shtimes, e cila i ka rezistuar kohës. Gjatë periudhës së sundimit osman, në këtë shtëpi janë mbajtur shumë takime, mbledhje e kuvendime nga patrioti i kësaj ane të çështjes shqiptare si Mulla Syla, i cili ka organizuar takime për çlirim nga pushteti osman.

VI.12 Kroi i periudhës Iliro-Romake

Kroi i periudhës Iliro-romake ndodhet në fshatin Komogllavë dhe është vendosur në periudhën para romake, pasi që romakët për sistemet e ujësjellësit përdornin më së shumti gypa prej plumbi. Gjurmët e vendbanimit antik hasen në të gjitha anët e fshatit, sepse aty mund të gjenden shtresa hiri, blozë por edhe pjesë të enëve nga qeramika, që nga forma dhe përbërja që ka i takojnë poçerisë vendase (Dardane) të Antikës së vonshme.

VI.13 Gjetjet arkeologjike në Nikadin

Ne fshatin Nikadin, më saktësisht në kilometrin e dytë të daljes nga Ferizaj, gjendet një lokalitet arkeologjik shumë i çmuar i cili ruan shumë histori të llojit të kishës paleokristiane. Objektet e gjetura në këtë lokalitet janë të një rëndësie të veçantë dhe prezanton kohën e vjetër të civilizimit në këtë rajon.

VI.14 Ansambël ndërtesash në Jezerc

Ky ansambël ndërtesash të ndërtuara nga guri dhe kryesisht këto tipe të shtëpive janë të ndërtuara në vendet rurale siç është kjo e fshatit Jezerc. QRTK në Ferizaj në bashkëpunim me Komisionin Evropian ka paraparë që këto shtëpi të restaurohen dhe të vendosën në dispozicion për vizitorë dhe të shndërrohen në bujtina për vizitorë.

Tabela Nr. 15: Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme

Nr.	*Emërtimi*	*Periudhat*	*Vendi , Komuna*	*Statusi Nr. i Vendimit*	*Nr. Unik në Databazë*
1.	*Lokaliteti Arkeologjik në Varosh*	*Parahistori*	*Varosh- Ferizaj*		*003443*
2.	*Lokaliteti Arkeologjik në Nikadin*	*Neolit- Antikë*	*Nikadin- Ferizaj*		*003444*
3.	*Lokaliteti shumështresor arkeologjik në Sojevë*	*Parahistori, Antikë, Mesjetë*	*Sojevë- Ferizaj*		*003445*
4.	*Lokaliteti Arkeologjik në Komogllavë*	*Antikë, Mesjetë*	*Komogllavë- Ferizaj*		*003446*
5.	*Lokaliteti Arkeologjik në*	*Antikë, Mesjetë*	*Rahovicë- Ferizaj*		*003447*
6.	*Lokaliteti Arkeologjik në Pleshinë*	*Antikë, Mesjetë*	*Pleshinë-Ferizaj*		*003448*
7.	*Lokaliteti Arkeologjik në Greme*	*Antikë, Mesjetë*	*Greme- Ferizaj*		*003449*
8.	*Lokaliteti Arkeologjik në Neredime të Epërme*	*Antikë,Mesjetë*	*Neredime të Epërme-Ferizaj*		*0034450*
9.	*Lokaliteti Arkeologjik në*	*Antikë,Mesjetë*	*Neredime të Poshtme-Ferizaj*		*0034451*

	Neredime të Poshtme				
10.	*Lokaliteti Arkeologjik te "Livadhet e Kishës" në Jezerc*	*Antikë, Mesjetë*	*Jezerc-Ferizaj*		*0034452*
11.	*Lokaliteti Arkeologjik në Surqinë*	*Antikë, Mesjetë*	*Surqinë-Ferizaj*		*0034453*
12.	*Lokaliteti Arkeologjik në "Gjyteti" në Jezerc*	*Antikitet i Vonë*	*Jezerc-Ferizaj*		*0034454*
13.	*Kisha Paleokristiane Nikadin*	*Antikitet i Vonë*	*Nikadin- Ferizaj*		*003666*
14.	*Lokaliteti Arkeologjik Periudha e Bronzit në Varosh*	*Parahistori*	*Varosh- Ferizaj*		*003701*
15.	*Gërmadhat e Qytetit Antik Petriçi(Petriçi i Madh dhe i Vogël në Petriç)*	*Antikitet i Vonë, Mesjetë*	*Neredime e Epërme - Ferizaj*	*02959/67*	*003033*
16.	*Lokaliteti Arkeologjik dhe Kisha Mesjetare*	*Antikitet i Vonë, Mesjetë*	*Surqinë,Rahovicë-Ferizaj*	*02960/67*	*002901*

17.	*Lokaliteti Arkeologjik-Tuma Gur*	*Antikitet i Vonë, Mesjetë*	*Zaskok-Ferizaj*	*02-431/80*	*003034*
18.	*Lokaliteti Arkeologjik-Pusi i Gogës*	*Parahistori*	*Babush-Ferizaj*	*0301-629/85*	*003035*
19.	*Kalaja e Izhancit*	*Antikitet i Vonë, Mesjetë*	*Burrnik-Ferizaj*	*0301-633/85*	*003036*
20.	*Nekropoli tumular i Gërlicës*	*Parahistori*	*Gërlicë-Ferizaj*	*0301-634/85*	*003037*
21.	*Lokaliteti Neolitik në Zllatar*	*Parahistori*	*Zllatar-Ferizaj*		*003716*
22.	*Kisha në Ferizaj,Koleksioni i Kishave të Uroshit*	*Shek.XVIII-XIX-të,*	*Ferizaj*	*02-595/65*	*002886*
23.	*Ndërtesa ku është vendosur Teatri i Qytetit*	*Shek.XX*	*Ferizaj*		*003462*
24.	*Kompleksi i Kishës Katolike*	*Shek.XX*	*Ferizaj*		*004246*
25.	*Ndërtesa e shkollës fillore "Jeronim de Rada"*	*Shek.XX*	*Ferizaj*		*003463*
26.	*Ndërtesa e Stacionit*	*Shek.XIX*	*Ferizaj*		*003464*
27.	*Ndërtesa Biblioteka e Madhe*	*Shek.XX*	*Ferizaj*		*003465*

VII. Përkufizimi i problemit

Problemi kryesor i Komunës së Ferizajt lidhet me rregullimin e infrastrukturës fizike në zonat turistike, rregullimi i infrastrukturës digjitale dhe marketingut si dhe pjesa e burimeve njerëzore dhe kuadrove sa më të përgatitur.

VIII. Krahasimi me vendet/komunat tjera

Komuna e Ferizajt dallohet me komunat tjera për shkak të mikpritjes së gjerë, dinamikës së zhvillimit, zhvillimit të tregtisë, jetës së natës dhe diversitetit të popullsisë. Në Ferizaj janë qytetarë të ardhur nga viset tjera që tani jetojnë aty si dhe popullsia vendase.

Ferizaj krahasohet me qytetet tjera për faktin se posedon monumente dhe veçori që e dallojnë prej qyteteve tjera, sepse ka lumin, si dhe Bifurkacionin që është fenomeni natyror i vetmi në Evropë dhe i dyti në botë. Gjithashtu, Ferizaj veçohet edhe për faktin se ka Xhaminë dhe Kishën në një oborr. Ferizaj ka malet e saj dhe sidomos pjesa e Jezercit dhe Neredimes që e bëjnë vend atraktiv, kurse pjesa e relievit dhe pjesa e turizmit është e ngjashme me pjesën e tjetër të Kosovës dhe turizmi rural, malor dhe urban është i ngjashëm me vendet tjera në Kosovë.

IX. Analiza e problemit dhe mundësive për zgjidhje

Pjesa e infrastrukturës fizike në Ferizaj ka përparim, por ka ende pjesë të rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit dhe pjesa e internetit, energjisë elektrike janë ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen sidomos pjesa e vendeve malore dhe turistike. Ferizaj ende nuk ka uebfaqe të turizmit dhe pak të dhëna për turistët te pjesa e vendeve turistike dhe potencialit turistik, pak informacione lidhur me turizmin dhe ka mungesë të burimeve njerëzore të kualifikuar si ciceronë, tour operator, kamarierë dhe kuzhinierë.

Për t'i zgjidhur këto sfida nevojiten mund dhe angazhim si rregullimi i infrastrukturës, energjisë elektrike dhe internetit, rregullimi i ëebfaqes dhe aplikacioneve të ndryshme dhe trajnime të ndryshme për ciceronë dhe veprimtari që lidhen me hotele dhe restorante.

X. Swot Analiza


PËRPARËSITË	DOBËSITË
Përparësitë: -Trashëgimia kulturore -Tradita mikpritëse e qytetit -Fryma multi-kulturore -Qasja përmes autostradave dhe Rruga e Kombit-Shqipëri -Pozita gjeografike e Ferizajt -Afërsia me Shqipërinë dhe Maqedoninë -Natyra e bukur e Maleve të Sharrit -Gatishmëria e institucioneve lokale për përkrahje të turizmit -Kuzhina tradicionale (psh. Djathi i Sharrit) - Ekzistenca e veprimtarive artizanale (psh. punimet e filigranit) - Rinia dhe atmosfera pozitive që mbretëron, kultura miqësore dhe mikpritëse. -Afërsia me qendrat kryesore të Ballkanit; -E kaluara e veçantë historike; -Jeta e natës.	Dobësitë: -Mungesa e parkingjeve të qasshme dhe të konvenueshme; -Pengesat në qasje të objekteve të trashëgimisë kulturore; -Mos-promovimi i guidave lokale; -Mungesa e brendimit të qytetit; -Qëndrimet e shkurtra të vizitorëve; -Mbeturinat afër atraksioneve kryesore turistike; -Mungesa e një mekanizmi të përbashkët e punimit të akterëve të turizmit; -Numri i limituar i restoranteve me kuzhinë tradicionale; -Mungesa e produkteve turistike; -Mungesa e transportit publik nga aeroporti; -Mungesa e hartave informuese turistike; -Numri i limituar i muzeve/ hapësirave kulturore dhe mosfunksionimi i tyre në kohë të përshtatshme; -Mungesa e materialeve promovuese turistike -Mungesa e tuor-operatorëve që dijnë gjuhë tjera përpos anglishtes.

MUNDËSITË	RREZIQET
Mundësitë -Përmirësimi i rrjedhës së informacionit përmes qëndrave informuese, katalogjeve dhe mjeteve tjera digjitale -Promovimi i traditës artizanale -Lehtësimi i qasjes në objekte të trashëgimisë kulturore -Ngritja e kapaciteteve njerëzore profesionale - Zhvillimi i produkteve dhe aktiviteteve turistike - Përmirësimi i infrastrukturës; -Përmirësimi i rrjedhës së informacionit përmes qendrave informuese, shenjëzimit, katalogjeve dhe mjeteve tjera digjitale. - Promovimi përmes platformave ndërkombëtare - Hapja e muzeve historike dhe kulturore dhe inicimi i bashkëpunimit në mes tyre; - Ofrimi i shërbimeve më të mira të transportit publik;	**Kërcënimet:** - Mungesa e bashkëpunimit në mes të akterëve për zhvillim të turizmit - Konkurrenca nga vendet tjera të rajonit - Mungesa e gatishmërisë për t'i komercializuar produktet; - Kriza potenciale ekonomike në vendet që janë burim i turizmit -Klima jo e favorshme e biznesit dhe informacionet negative në arenën ndërkombëtare. -Ikja e rinisë dhe kuadrove profesionale jashtë vendit.

XI. Analiza e indikatorëve zhvillimor

Indikatorët zhvillimor të turizmit në Komunën e Ferizajt e përfshin vëllimin dhe dinamikën e qëndrimit dhe të vizitave, konsumimit, karakteristikat cilësore të prodhimeve turistike, netët e realizuara, kapacitetet vendosësh, punësimi dhe shpërndarja e të hyrave nga turizmi. Indikatorët zhvillimor do të analizohen me qëllim që të vërtetohen gjendjet në këtë sferë dhe të paramendohen përmirësime të cilat çojnë kah zhvillimi i turizmit. Raporti në mes netëve të realizuara dhe vizitave na mundëson që ta shikojmë dinamikën e qëndrimit mesatar në komunë.

Grafiku nr. – Indikatorët zhvillimor



XI.1 Vizitorët

Vizitorët janë indikatorë kryesor i zhvillimit të turizmit. Ai mundëson që të shikohen karakteristikat e segmentit të veçantë nga qarkullimi i turizmit në kuptimin kualitativ dhe të përcaktohen edhe ndryshohen vlerat e padëshiruara. Në bazë të këtyre treguesve duhet të dimensionohen përmirësimet e mundshme të cilat do të prezantohen si zgjidhje cilësore. Karakteristikat e turistëve të huaj janë të ilustruara në atë mënyrë, e cila është e prezantuar përmes treguesve të posaçëm.


Tabela 1. Dhe Grafiku 1, kemi numrin e vizitorëve vendor dhe të huaj dhe netë-qëndrimet e tyre në Regjionin e Ferizajt në vitet 2020-2021

Viti	Periudha	Vendor		Të huaj		Totali	
		Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë
2020	TM1	954	1,193	801	1,143	1,755	2,336
	TM2	76	125	176	239	252	364
	TM3	337	516	515	1,189	852	1,705
	TM4	429	484	723	1,290	1,152	1,774
Totali		**1,796**	**2,318**	**2,215**	**3,861**	**4,011**	**6,179**
2021	TM1	2,069	2,550	1,176	1,927	3,245	4,477
	TM2	2,364	3,120	1,621	2,686	3,985	5,806
	TM3	3,188	4,741	2,589	5,248	5,777	9,989
	TM4	8,449	11,466	5,593	4,936	14,042	16,402
Totali		**16,070**	**21,877**	**10,979**	**14,797**	**27,049**	**36,674**

Burimi: Raportet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për Statistikat e Hotelerisë 2020-2021

Në tabelën 1 paraqiten të dhënat për qarkullimin turistik në Regjionin e Ferizajt përgjatë katër (4) tremujorëve të viteve 2020 dhe 2021. Janë marr në shqyrtim dy vitet e kaluara me qëllim të krahasueshmërisë se a ka pasur rritje apo rënie të qarkullimit turistik, përkatësisht numrit të vizitorëve vendor dhe të huaj. Edhe më qartë një gjë të tillë mund ta shohim përmes grafikut të mëposhtëm.

Grafiku 1. Numri i vizitorëve vendor dhe të huaj dhe netë-qëndrimet e tyre në Regjionin e Ferizajt në vitet 2020-2021



Burimi: Agjencioni i Statistikave

Nga grafiku 1 shohim se përveç në tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2020, numri total i vizitorëve (vendor dhe të huaj) në Regjionin e Ferizajt vazhdimisht ka shënuar rritje. Kjo lë të kuptohet se atraktiviteti turistik i këtij regjioni është shtuar çdoherë e më shumë pasi që qarkullimi turistik ka pasur progres të vazhdueshëm. Nëse i krahasojmë tremujorin e tretë (TM3) dhe tremujorin e katërt (TM4) të vitit 2021 vërehet një rritje prej rreth 2.5 herë e numrit total të vizitorëve. Ndërsa, nëse iu referohemi shifrave totale të këtyre 2 viteve të paraqitura në analizë del se në vitin 2020 numri total i vizitorëve (vendor dhe të huaj) në Regjionin e Ferizajt ka qenë 4,011 ndërsa në vitin 2021 ka qenë 27,049, që do të thotë nga viti në vit, numri i vizitorëve është rritur prej më shumë se 6.5 herë. Kështu, në këtë pjesë paraqesim disa nga statistikat më të rëndësishme për Regjionin e Ferizajt që kanë të bëjnë me kapacitetet hoteliere dhe me qarkullimin turistik.

XI.2 Kapacitet hoteliere të Ferizajt

Tabela 2. Kapacitetet hoteliere në Regjionin e Ferizajt

Viti	Periudha	Njësi akomoduese	Dhoma	Shtretër
2020	**TM1**	63	814	1,049
	TM2	63	814	1,049
	TM3	63	814	1,049
	TM4	**63**	**814**	**1,049**
2021	**TM1**	64	886	1136
	TM2	64	886	1136
	TM3	64	886	1136
	TM4	**64**	**886**	**1136**

Burimi: Raportet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për Statistikat e Hotelerisë 2020-2021 (Përshtatur nga autorja)

Nga tabela 1 shohim se numri i kapaciteteve hoteliere në Regjionin e Ferizajt ka pësuar një ndryshim minimalistik nga viti 2020 në vitin 2021, përkatësisht nga 63 njësi akomoduese sa ishin në vitin 2020 numri është rritur në 64 njësi akomoduese në vitin 2021 dhe kjo ka shtuar pastaj edhe numrin e dhomave dhe shtretërve në dispozicion për turistët që e vizitojnë këtë regjion.

Tabela 3: Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjioneve

ID	Regjioni	Njësi akomoduese	Dhoma	Shtretër
1	Gjakova	29	374	513
2	Gjilani	35	490	717
3	Mitrovica	29	484	734
4	Peja	93	1.235	2.327
5	Prizreni	88	1.297	2.593
6	Prishtina	161	2.785	3.791
7	Ferizaji	64	886	1.136
Gjithsej		**499**	**7.551**	**11.811**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Nga tabela 1. nxjerrim përfundim se kapacitetet hoteleriere ne Regjionin e Ferizajt janë mesatare. Regjioni i Ferizajt ka më shumë kapacitet se Regjioni i Gjakovës, Gjilanit dhe Mitrovicës por më pak se Regjioni i Pejës, Prizrenit dhe Prishtinës.

Nëse bazohemi në statistikat nga Tab. 4: Shfrytëzimi i kapaciteteve hoteliere në Kosovë të anketuara në përqindje (%), publikuar në "Statistikat e Hotelerisë TM4 2021", ASK-së, mars 2022, Prishtinë, f7, ku prezantohet Shkalla e Shfrytëzimit të Kapaciteteve Hoteliere në Kosovë të anketuara në përqindje (%), sipas anketës del se kapaciteti i shfrytëzuar i kapaciteteve ekzistuese në nivel vendi është 12.9 %, ndërsa në Regjionin e Ferizajt për vitin 2021 është 9.55 % atëherë del se Regjioni i Ferizajt ka shumë kapacitete të pashfrytëzuara hoteliere dhe njëri ndër objektivat e strategjisë duhet te jetë rritja e shkallës se shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese.

Pra, rekomandimi është që të hulumtohen modalitete për rritjen e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese.

Vizitorët vendor dhe të jashtëm me net-qendrimet e tyre

Tabela 4: Numri i vizitorëve vendor dhe net-qëndrimet e tyre për periudhat TM4, 2019 – 2021

ID	Regjionet	TM4 2019		TM4 2020		TM4 2021	
		Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë
1	Gjakovë	955	1.420	316	453	538	725
2	Gjilan	1.960	2.212	282	288	1.840	2.144
3	Mitrovicë	2.937	2.989	1.287	1.290	4.824	4.867
4	Pejë	8.422	17.330	9.870	20.401	7.971	13.628
5	Prizren	4.876	5.964	4.265	4.669	6.483	9.690
6	Prishtinë	6.190	8.833	6.035	9.262	9.906	14.883
7	Ferizaj	870	1.240	429	484	8.449	11.466
Gjithsej		**26.209**	**39.990**	**22.483**	**36.848**	**40.012**	**57.404**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në TM4 2021 numri i vizitorëve vendor është 40,012 ndërsa numri i net-qëndrimeve të tyre është 57,404. Numri më i madh i vizitorëve vendor vërehet në Regjionin e Prishtinës me 9 906 vizitorë dhe 14 883 net-qëndrimi. Vlen të potencohet se Regjioni i Ferizajt në TM4 2021 është menjëherë pas Regjionit të Prishtinës sa i përket numrit të vizitorëve vendor me 8449 vizitorë dhe pas Regjionit të Prishtinës dhe Pejës sa i përket net-qëndrimi, me 11466 net-qëndrimi.

Tabela 5: Numri i vizitorëve të jashtëm dhe net-qëndrimet e tyre, sipas regjioneve për TM4, 19 - 21

ID	Regjionet	TM4 2019		TM4 2020		TM4 2021	
		Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë	Vizitorë	Netë
1	Gjakovë	805	1.457	255	600	984	1.242
2	Gjilan	465	709	427	751	1.299	1.613
3	Mitrovicë	1.778	1.875	3.768	3.832	5.242	4.844
4	Pejë	5.883	13.651	4.532	10.374	9.603	10.415
5	Prizren	6.867	9.252	5.043	6.245	10.559	12.670
6	Prishtinë	24.644	45.735	14.654	29.176	35.794	44.435
7	Ferizaj	841	1.541	723	1.290	5.593	4.936
Gjithsej		**41.283**	**74.219**	**29.402**	**52.268**	**69.074**	**80.154**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në TM4 2021, numri i vizitorëve të jashtëm është 69,074 ndërsa numri i net-qëndrimeve të tyre është 80, 154. Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe mandej vjen Ferizaj. Nga kjo mund të përfundojmë se Ferizaj në TMK4, viti 2021 ka pasur shumë me shumë vizitorë vendor që ishin 8449 vizitorë përkundër vizitorëve të jashtëm që ishin 5593. Gjithashtu, kishte edhe një dallim të madh të net-qëndrimi me 11,466 net-qëndrimi të vizitorëve vendor dhe vetëm 4,936 net-qëndrimi të vizitorëve të jashtëm. **Nga kjo, gjithashtu del rekomandimi 2 që në objektivat e strategjisë krahas rritjes së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese duhet një fokus në vizitorin e jashtëm.**

XI.3 Trendet globale të turizmit

Turizmi është njëri ndër sektorët më të mëdhenj në ekonominë globale, dhe po shënon një ritëm të hovshëm të rritjes. Numri i ardhjeve të turistëve ndërkombëtar është ngritur nga 25 milionë sa ishte në vitin 1950 në 1.2 miliardë në vitin 2016 apo 14 miliardë në vitin 2019. Parashikimet janë që në vitin 2030, numri i përgjithshëm i ardhjeve të arrij në 1.8 miliardë. Destinacionet që vizitohen më së shumti nga turistët janë: Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Spanja dhe Kina. Kohëve të fundit, rritje e konsiderueshme e numrit të vizitorëve është shënuar në vendet aziatike dhe ato afrikane. Në anën tjetër, SHBA-të dhe Kina janë burimet kryesore të turizmit(në bazë të numrit dhe shpenzimeve) në botë.

Burimi: UNËTO 2017

Figura 1: Numri i ardhjeve të turistëve ndërkombëtar (1950-2030)

Ky sektor luan një rol domethënës në zhvillim ekonomik, duke ndikuar posaçërisht në krijim të vendeve të punës dhe në rritje të eksportit të shërbimeve. Në vitin 2016, ky sektor (duke përfshirë ndikimin e tij të gjerë) ka kontribuar në ekonominë botërore me 7.6 bilionë USD, ka qenë përgjegjës për krijimin e rreth 292 milionë vende të punës. Për t'i vendosur gjërat në perspektivë, turizmi thjesht përbën rreh 10% të ekonomisë së botës dhe vendeve të punës, si dhe 30% të eksportit të shërbimeve.

Me dinamikat e reja socio-ekonomike, turizmi si sektor ka shënuar transformimet e veta ne nivele të ndryshme. Më poshtë, janë të paraqitura trendet kryesore të zhvillimit të këtij sektori në botë sot:

XI.4 Përjetimi/eksperienca

Ditëve të sotme, turistët janë shumë të interesuar që të përjetojnë destinacione turistike të cilat janë të veçanta dhe autentike. Turistët nuk po mjaftohen vetëm me një vizitë të thjeshtë; ata tash janë të interesuar më shumë për kulturën dhe historikun e destinacionit, të kenë aventura që mbahen mend gjithë jetën dhe aktivitete të ngjashme interaktive të cilat e bëjnë përjetimin e paharrueshëm. Më një fjalë, aspekti i përjetimit është shndërruar në diçka qenësore në turizmin bashkëkohor.

XI.5 Transformimi digjital

Përcaktimi për destinacionet dhe rezervimet në të shumtën e rasteve(82%) bëhen përmes platformave online (booking.com, tripadvisor, trivago, airbnb–sa për t'i nënvizuar disa nga to). Rezervimet përmes telefonave mobil gati se janë dyfishuar krahasuar me vitin 2016–nga 31% në 49%. I gjithë ky transformim, përveç tjerash, ofron mundësi që e gjithë oferta para, gjatë dhe pas udhëtimit të jetë më lehtë e menaxhueshme dhe përgjithësisht më e veçantë.

Transformimet digjitale kanë ofruar mundësi që konsumatorët të kenë më të lehtë t'i ndajnë përshtypjet e tyre përmes vlerësimeve online. Kjo në njërën anë e bën që të reduktohet asimetria e informacionit në anën e kërkesës dhe njëkohësisht i nxit ofertuesit t'i përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre.

XI. 6 Siguria

Siguria është njëri nga aspektet më vitale në promovim dhe zhvillim të turizmit. Suksesi i një destinacioni turistik varet nga aftësia e vendit për të ofruar ambient të sigurt për vizitorët. Kjo çështje është bërë edhe më e rëndësishme në vitet e fundit me përhapjen e akteve terroriste dhe epidemive të ndryshme.

Duhet theksuar se përveç sigurisë fizike, në ditët e sotme mbrojtja dhe integriteti i të dhënave, siguria në ushqim dhe në shëndet në përgjithësi janë aspekte përcaktuese për t'i bindur turistët ta vizitojnë një vend.

XI.7 Qëndrueshmëria

Aspekti i qëndrueshmërisë është bërë aq i rëndësishëm sa që kohëve të fundit po organizohen edhe protesta në rrugë për ta ndaluar mbi-turizmin, i cili në formë të pakontrolluar po degradon destiancionet turistike. Si rezultat i këtij frustrimi, gjithnjë e më shumë është duke u punuar që të zhvillohen praktika që promovojnë sjellje të qëndrueshme, e cila e mbron ambientin dhe banorët lokal, duke mos i sakrifikuar të hyrat nga turizmi.

XI.8 Tregjet e reja

Tregjet aziatike: ritmi i shpejtë i zhvillimit ekonomik, hapja e tregut dhe lehtësirat e ofruara në udhëtim, kanë bërë që Azia të bëhet ndër tregjet me të mëdha të turizmit në botë.

Mijëvjeçarët të nxitur nga udhëtimet të mbushura me përvoja si dhe nga rrjetet sociale, mijëvjeçarët janë shndërruar në një kategori të turistëve që kanë rol të rëndësishëm në formësimin e turizmit në botë.

Udhëtarët grasolo: Interesimi dhe numri i udhëtarëve grasolo është duke u rritur gradualisht, veçanërisht në tri vitet e fundit. Për ilustrim, mesatarja e kërkimeve në Google për këtë kategori është rritur për 52% krahasuar me vitin paraprak. Për më shumë, sipas Trip Advisor, në vitin 2015, nga të gjitha gratë udhëtare, 74% kanë udhëtuar solo se kanë qenë duke planifikuar të udhëtojnë në këtë mënyrë.

Pensionistët (65+): Pensionistët janë udhëtarë mjaft intenziv dhe segment qenësor i turizmit në botë. Në mesatare, përbëjnë rreth 20% të turizmit ndërkombëtar. Një nga arsyet, pse ata udhëtojnë është koha e lirë që e kanë në pension. Ata synojnë të kuptojnë më shumë mbi historinë e vendeve dhe të kenë mundësi për socializim.

XII. Analiza e katër parimeve-Komuna e Ferizajt

Tabela Nr.9: Analiza e katër parimeve —Komuna e Ferizajt

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet /Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Qasja në Kapital	1. Pengesa në infrastrukturën ligjore: 2. Çështjet lidhur me pronësinë 3. Privatizimi jo adekuat 4. Mospërdorimi i kapaciteteve ekzistuese 5. Kostoja e lartë e kapitalit financiar (kamatat e larta dhe afatet e shkurta) 6. Mungesa infrastrukturës në zona malore	1. Eliminimi dhe gjetja e zgjidhjeve të pjesës së infastrukturës, dhe zgjidhjeve të problemeve	1. Resurset natyrore 2. Edukimi adekuat 3. Lokacionet për investime 4. Kushtet tokësore dhe klimatike 5.Kapacitetet ekzistuese: Hotelet, motelet, Jezerci, Neredimja, agjensionet, ciceronët. 6. Fuqia punëtore e kualifikuar	1. Përdorimi i kapaciteteve ekzistuese 2. Toka dhe tërheqja e kapitalit të brendshëm dhe atij të jashtëm 3. Krijimi i ndërmarrjeve të reja publiko-private 4. Rrit vetëdijesimin përmes projekteve kreative	Duhet ndryshuar infrastruktura ligjore dhe fizike per rregullimin e problemeve.
Mjedisi për turizëm	1. Pengesat në infrastrukturën ligjore 2. Politika fiskale 3. Siguria e industrisë turistike dhe e kapitalit 4. Mospërkrahja e institucioneve qendrore 5. Infrastruktura në zona për turizëm 6. Rrugët 7. Investitorëve lokal iu mungon infrastruktura	1. Lehtësira finaciare nga Qeveria për investime në turizëm 2. Lokacionet e reja për zhvillim të turizmit	1. Resurset natyrore: toka, kushtet klimatike, tradita kulturore 2. Fuqia punëtore e duhur 3. Kapacitetet prezente të turizmit	1. Përdorimi i kapaciteteve prezente 2. Mundësitë për investime në turizëm 3. Mundësia për të tërhequr kapital nga vendorët që punojnë jashtë vendit 4. Realizimi e zonave të reja	1.Përforcimi me investime në programe të reja 2. Vizitat dhe kontaktet me shtetet që e kanë zhvilluar turizmin

	rregulluese dhe funksionale	3. Trajnimi i specializuar		ekonomiko-turistike 5. Koordinimi dhe bashkëpunimi me sektorin e biznesit	
Infrastruktura e krijuar	1. Mungesa buxhetore 2. Pengesat në infrastrukturën ligjore: çështjet pronësore 3. Politika e papërshtatshme fiskale 4. Siguria 5. Mosfunksionimi apo mosshfrytzimi adekuat i burimeve të ujit	1. Rrugët 2. Sistemet e kanalizimit dhe mirëmbajtjes së tij 3. Rrjeti i ujësjellësit dhe burimeve të ujit 4.Furnizimi i qëndrueshëm, 24-orësh me rrymë elektrike 5. Përpunimi i ujërave të zeza dhe i mbeturinave	1. Toka 2. Fuqia punëtore e kualifikuar dhe e re 3. Fuqia e lirë punëtore 4. Implementimi i planit për furnizim me ujë 5. Ndërtimi i kolektorit dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza 6. Rritja e komunikimit ndërmjet Komunës me komunitetin dhe bizneset 7. Krijimi i fondit për zhvillim të turizmit, Komuna dhe komuniteti 8. Universitetet; 9. Pasuritë natyrore 10. Aktivitetet kulturore të Komunës	1. Gatishmëria e bizneseve për të investuar 2. Gatishmëria e komunitetit për të marrë pjesë 3. Gatishmëria e KK për t'i kthyer në mënyrë indirekte të ardhurat vjetore që vijnë nga bizneset (taksat dhe pagesat tjera) për zhvillim të infrastrukturës 4. Klima lokale dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve për turizëm 5. Donacionet—të jashtme dhe të brendshme	1. Kushtet prezente 2. Qëllimet (planet për të ardhmen) 3. Grantet qeveritare 4. Kapitali i KK

			11. Shoqëria e organizuar civile 12. Rritja e vetëdijësimit për mbrojtjen e natyrës	6. OJQ-të dhe organizatat profesionale 7. Shkollat profesionale 8. Lokacionet e investimeve në turizëm	
Burimet Turistike / Akterët e zhvillimit të turizmit	2. Mosfinacimi i aktiviteteve kulturore nga Qeveria 3. Mungesa e shkollave që sigurojnë përgatitje profesionale 4. Mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe bizneseve 6. Mos stimulimi i ekspertëve 7. Mungesa e qendrës megakulturore dhe qendrës pedagogjike 8. Papunësia e lartë 9. Mungesa e aktiviteteve kulturore-sportive në rajonet rurale 10. Mungesa e stafit lokal profesional për edukim joformal	1. Arsimi i orientuar drejt kërkesave profesionale 2. Donatorët: stimulimi i investitorëve lokal 3. Organizimi i kurseve të ndryshme me licencim dhe çertifikim 5. Koordinimi ndërmjet institucioneve dhe bizneseve.		1. Shkollat — fakultetet	Mekanizmat e identifikimit të problemeve të paraqitura ne pjesën e problemeve të paraqitura në këtë pjesë.

	11. Shërbimet komunale 12. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore 13. Mungesa e kontrollimit të vendeve për hedhjen e mbeturinave 14. Qasje joinstitucionale e vlerave—mungesa e ligjeve 15. Qasja jo e drejtë e bizneseve	6. Marketingu			

Realizimi i objektivave të forta strategjike në lidhjen e ngushtë të kultivimit të raporteve në tregut turistik dhe krijimin e politikave për qasje në planin nacional dhe ndërkombëtar. Kjo do të thotë se përkundër mundësive të shqyrtuara për krijimin e ofertës turistike dhe prodhimet e veçanta turistike, është e domosdoshme edhe kultivimi i kërkesës turistike. Kështu do të mundet të konstatohen prioritetet e tregut turistik në bazë të asaj që do të definohet dhe format e kanalet e qasjes në kushtet e caktuara kohore dhe hapësinore.

Krijimi i planit aksional nënkupton planifikimin e masave dhe aktiviteteve me definimin e resurseve për realizimin e tyre. Në planin aksional janë të përfshira komponentë të cilat janë relevante që të realizohen objektivat e parashikuara. Në të janë përcaktuar prioritetet: Ato përfshijnë përmbajtje të cilat kanë karakter të mundësive operative për përdorim. Që të realizohen objektivat parësore është e domosdoshme që të bëhet analiza dhe të përcaktohen aktivitetet, të cilat duhet të ndërmerren që të mund të vie deri te zhvillimi optimal i prioriteteve, respektivisht përdorimin e potencialeve. Në drejtim të ndërmarrjes së përgjegjësive për realizimin e zhvillimit të prioriteteve, hulumtimi përfshiu konstatimin e bartësve të cilët do të jenë të obliguar për këtë realizim, partnerë dhe mbështetës në gjithë procesin. Modelet e realizimit janë shumë të rëndësishëm dhe ekipi hulumtues kujdes të veçantë i ka kushtuar posaçërisht këtij segmenti me atë që i ka përcaktuar format dhe përmbajtjet të cilat do të jenë në funksion të avansimit të rajonit në tërësi dhe raporteve infra rajonale.

XIII. Sfidat kryesore për zhvillimin e turizmit në Komunën e Ferizajt

- Të siguroj që Ferizaj të jetë një ndër destinacionet kryesore turistike në Kosovë;
- Të siguroj qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e rritjes së sektorit të turizmit;
- Të stimulojë rritjen e vazhdueshme të ekonomisë lokale përmes tërheqjes së investimeve në turizëm;
- Të shfrytëzoj kapacitetet e ekonomisë lokale edhe si destinacion turistik.
- Ferizaj duhet të promovohet gjërësisht në komunitetin vendor dhe ndërkombëtar, si një destinacion i denjë për të konkuruar barabartë në tregun global të turizmit.
- Mbrojtjen dhe zhvillimin e rregullt të gjeohapësirave në respekt të natyrës, Bifukacionit, turizmit rural (Jezerc, Neredime, Burrnik), zhvillimit demografik dhe urban në të gjitha zonat me potencial zhvillimin e turizmit.

XIV. Prioritetet strategjike për zhvillimin e turizmit në Komunën e Ferizajt

Në takimet e mbajtura Grupi Punues ka vlerësuar strategjitë dhe ka zgjedhur një apo dy projekte më prioritare për secilin prej synimeve strategjike. Si shtesë, janë zhvilluar detyrat për të implementuar strategjitë dhe afatet e përafërta kohore. Këto strategji dhe plane të veprimit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.10. Prioritetet dhe qëllimet strategjike

Prioriteti Strategjik Nr.1	*Zhvillimi i Turizmit Rural dhe Malor*	*Qëllimi 1. Krijimi i Komitetit (Këshillit) Turistik për zhvillimin e turizmit komunal*	*Qellimi 2. Marketingu kombëtar dhe ndërkufitar dhe zyrave koordinuese turistike*
Prioriteti Strategjik Nr.2	Zhvillimi dhe zgjerimi i turizmit kulturor	Ferizaj qendër kulturore mbarëshqiptare	Bashkëpunimi ndërinstitutional
Prioriteti Strategjik Nr.3	Zhvillimi i turizmit me akomodim më të gjatë	Programi garues për shtigjet e ecjes në të gjithë sezonet	Licencimi i familjeve mikpritëse në zonat rurale Çertifikimi i menysë "Ferizaj"
Prioriteti Strategjik Nr.4	Zhvillimi i turizmit sportiv dhe rekreativ	Ndërtimi i qendrës sportive	Ndërtimi i pishinës së mbyllur olimpike të notit

XV. Qëllimi bazik dhe operativ i strategjisë të Komunës së Ferizajt

Në bazë të analizave të përgjithshme për karakteristikat e zhvillimit të turizmit në Komunën e Ferizajt si dhe në bazë të analizës së situatës, indikatorëve zhvillimor dhe analizave SËOT është përcaktuar qëllimi bazik strategjik dhe qëllimet operative.

Qëllimi bazik i strategjisë së Komunës së Ferizajt

Ngritja e veprimtarisë turistike në Komunë në një nivel më të lartë, i cili do të gjeneroj afirmimin e Komunës si destinacion turistik i dallueshëm në planin vendor dhe ndërkombëtar**.**

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik janë definuar qëllimet operative në vijim:

- **Shfrytëzimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve hapësinore në zhvillimin e turizmit**

Komuna e Ferizajt ka një pozitë gjeografike e cila duhet të shfrytëzohet në mënyrë të dyfishtë për zhvillimin e turizmit. Kjo i ndihmon që të shfrytëzohet si vlerë më vete në prizmin e pranimit të turistëve transitorë, por njëherësh të shfrytëzohet si aktivitet operativ për përmirësimin e ofertës turistike në prizmin e aktiviteteve kontaktuese me komunat fqinje dhe Republikën e Kosovës në planin ndërkombëtar. Përmes shfrytëzimit polivalent të resurseve, Komuna duhet të përmirësoj përmbajtjen e ofertës turistike.

Në aspekt të komunikimit, Komuna gjendet përballë sfidave, të cilat ajo duhet t'i zgjidh në vazhdë të shfrytëzimit të resurseve të komunikacionit dhe rrethinës së saj. Përmirësimi i tyre do të jetë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të turizmit. Zhvillimi i turizmit duhet të bëhet në korrelacion me karakteristikat e infrastrukturës dhe mundësisë së lidhjeve.

- **Krijimi i imazhit si një destinacion turistik të suksesshëm përmes rritjes së konkurrencës**

Kjo nënkupton marrjen e të gjitha masave të cilat do të mundësojnë që në ofertën turistike të gjejnë vend jo vetëm atraksionet turistike afirmative, por edhe potencialet e shquara të këtij lloji në komunë.

- **Avancimi i resurseve receptive.**

Me zbatimin e standardizimeve, kategorizimeve dhe proceseve për përcaktimin e kushteve të lokacioneve të planifikuara do të kontribuohet në rritjen e cilësisë së përmbajtjes turistike dhe rritjen e të qenurit më konkurrent në tregun turistik.

- **Avancimi i strukturës organizative dhe përshtatjes së rregullativës normative për zhvillimin e turizmit**

Struktura organizative duhet të avancohet me qëllim që të përmirësohen rezultatet e aktivitetit turistik në Komunë. Kjo nënkupton një raport të respektueshëm drejt lehtësimeve të popullatës lokale, përshtatshmërisë organizative në shfrytëzimin e fondeve të ndryshme, përshtatshmërisë organizative në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe në pjesëmarrjen aktive në planin organizativ në sferën e veprimtarisë turistike brenda dhe jashtë Komunës.

- **Përmirësim të shfrytëzimit të dijeve dhe aftësive të burimeve njerëzore dhe avancimin e e tyre**

Ky qëllim do të realizohet përmes formave të arsimimit permanent, trajnimin e trajnuesve, nxitjen e popullatës së gjinisë femërore për pjesëmarrje në aktivitetet turistike dhe trajnime speciale, të cilat kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e ofertës turistike me kërkesat e kërkuesve të shërbimeve. Në veçanti është e rëndësishme të ketë qasje të qëndrueshme në veprimtarinë e ciceronëve dhe animatorëve, si dhe në ngritjen e vetëdijes së popullatës lokale për rëndësinë e turizmit.

- **Rritja e qarkullimit turistik dhe konsumit turistik.**

Realizimi i këtij qëllimi do të varet nga niveli i angazhimit në sferën e avancimit të përmbajtjeve të qëndrimit turistik, në veçanti nga aspekti i shkatërrimit të sezonaliteti. Paraqitja më e denjë në tregun turistik do të sjell deri tek rritja e qarkullimit turistik dhe rritja e konsumit turistik.

XVI. Akterët dhe funksionet relevante kryesore të turizmit në Komunën e Ferizajt

Ky seksion bën një përshkrim të shkurtër të akterëve dhe funksioneve kryesore në industrinë e turizmit në Ferizaj në njërën anë si dhe njëkohësisht hedh dritë mbi akterët mbështetës aktiv dhe ambient mundësues/rregullues. Figura 4 paraqet në formë illustrative relievin e përgjithshëm.



Figura 4: Akterët dhe funksionet relevante të turizmit

- **Tur-operatorët dhe agjencitë turistike**

Në gjithë Kosovën janë afërsisht 20 tur-operatorë të licencuar. Një pjesë e tyre janë me lokacion në Komunën e Ferizajt. Një numër i vogël i tyre funksionojnë si individë të pavarur. Ndonëse me lokacion në Ferizaj, ata ofrojnë paketa për gjithë Kosovën.

Itineraret dhe gjatë si aetureve është kryesisht fleksibile dhe vendoset në bashkëpunim me vizitorët sipas interesave dhe kohës që kanë në dispozicion. Disa prej tyre bashkëpunojnë më tur-operatorët e shteteve të tjera dhe e mbulojnë Kosovën si nën-kontraktor.

- **Transporti**
- **Rent a Car**
- **Aeroporti**

I vetmi aeroport funksional në Kosovë "Aeroporti Ndërkombëtar - Adem Jashari" gjendet në një distancë prej 35 kilometrash nga Komuna e Ferizajt. Kjo përbën një përparësi të madhe të kësaj komune për të nxituar ardhjen e turistëve të huaj. Rreth 59% të turistëve të huaj që vizitojnë Ferizajn udhëtojnë me aeroplan në këtë aeroport. Përderisa afërsia është përparësi, numri i kufizuar i fluturimeve me buxhet të ulët ndikon në fluks të turistëve.

- **Autobusët**

Linjat urbane dhe urbano-periferike të qytetit të Ferizajt me rrethinë mbulohen nga autobusët e linjave ndërurbane dhe nga operatorët privat. Në ndërkohë është zhvilluar një Plan Mobiliteti, në bazë të të cilit do të ristrukturohet trafiku urban në Ferizaj. Problemi kryesor është mungesa e një linje direkte nga Stacioni i Autobusëve për në qendër të qytetit, si dhe nga aeroporti për në Ferizaj dhe anasjelltas.Gjithashtu, nuk ka informacione online të orareve të autobusëve në ndonjë gjuhë të huaj, përpos shqipes.

- **Taksitë**

Në Ferizaj operojnë kompani të taksive dhe ku në total janë përafërsisht rreth 300 makina. Përveç, kompanive të taksive, ekzistojnë edhe operator individual (auto-taksi), të cilët janë të licencuar nga Komuna e Ferizajt.

- **Akomodimi**

Siç është potencuar më herët, në Ferizaj operojnë gjithsej 64 njësi akomoduese, me 886 dhoma dhe me 1136 shtretër. Sa i përket statusit ligjor, shumica e tyre (rreth75%) janë biznese individuale. Në tërësi, oferta akomoduese nuk është e mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat aktuale të të gjitha profileve të turistëve. Madje disa prej tyre operojnë dukshëm nën potencialin e tyre. Sipas intervistave të realizuara, në krahasim me vendet fqinje, çmimi i njësive akomoduese, sidomos i hoteleve është më i lartë. TVSH-ja e lartë (18%) dhe mungesa e subvencioneve në Kosovë është njëra nga arsyet kryesore për këtë disavantazh në çmime. Këto njësi punësojnë një numër të konsiderueshëm punëtorësh – afërsisht 37% e tyre janë gra.

- **Restorantet, kafeteritë dhe shopingu**

Në Komunën e Ferizajt operojnë mbi 300 restorante të qëndrueshme me kuzhina të ndryshme: tradicionale, mediterane, italiane, franceze, aziatike dhe përgjithësisht ndërkombëtare. Anketa dalëse e zhvilluar me turistë në 2016-ën tregon se në një listë me 18 aspekte të cilat lidhen me turizmin, turistët e huaj, i kanë radhitur 'restorantet' në top tri vendet e para, duke i vlerësuar në mesatare me 4.42 pikë nga 5 sa ka qenë maksimumi.

Në përgjithësi, Ferizaji performon kënaqshëm në këtë aspekt.

Në gjithë qytetin operojnë gjithsej 200 kafeteri dhe bare (sipas të intervistuarve). Ato janë të koncentruara kryesisht në qendër të qytetit. Për më shumë, në Ferizaj janë disa qendra të mëdha të shopingut; dy janë brenda qytetit, ndërsa dy tjera në magjistralen për Ferizaj. Këto qendra nxisin ardhjen e vizitorëve një ditor nga vendet tjera të Kosovës.

- **Shërbimet mbështetëse aktive**
- **Oda e Hotelerisë dhe Turizmit e Kosovës**

OHTK-ja është themeluar në korrik të vitit 2020 dhe operon në tërë Kosovën, shtrihet në 7 regjione të Kosovës.

OHTK-ja është një fryt i një analize të gjatë dhe të hollësishme të një grupi të afaristëve, të cilët duke parë ngecje të mëdha në fushën e hotelierisë dhe turizmit janë bashkuar për t'i dhënë një kahje më pozitive fushës më të rëndësishme në vend.

Qëllimi i OHTK-së, është përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale, qendrore dhe rajonale, për identifikimin e mënyrave dhe hapave për krijimin e një mjedisi të favorshëm për përfshirjen sa më të gjerë të bizneseve hoteliere dhe atyre turistike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Organi kryesor në nivel qendror që merret ekskluzivisht me sektorin e turizmit është Divizioni i Turizmit. Ky divizion operon në kuadër të Departamentit të Industrisë në MTI dhe ka të punësuar 4 zyrtarë. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të këtij organi janë: propozimi, hartimi, dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit të turizmit; mbështetja në promovimin e Kosovës si destinacion turistik; mbështetja në bashkëpunim me asociacionet ndërkombëtare të turizmit dhe organizimi i panaireve dhe eventeve të ngjashme. Në anën tjetër, **Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është organi në përgjegjësi për promovimin e turizmit.**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore është organi kryesor në nivel qendror sa i përket mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Nën ombrellën e këtij departamenti, operojnë tri divizione: Divizioni për Trashëgimi Arkitekturore dhe Arkeologjike, Divizioni për Trashëgimi të Luajtshme dhe Shpirtërore dhe Divizioni për Menaxhim të Integruar.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit, përkatësisht Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës që operon nën MMPH është institucioni përgjegjës për krijimin e politikave për mbrojtje të ambientit dhe mbrojtje të natyrës.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit–Komuna e Ferizajt

Kjo është drejtoria përgjegjëse për zhvillim të turizmit në Ferizaj. Aktualisht kjo drejtori nuk e ka asnjë zyrtar, i/e cili/a merret ekskluzivisht me çështje të turizmit në komunë.

Ligji për turizmin dhe shërbimet turistike

Ky ligj rregullon parimet dhe përgjegjësitë e palëve për organizimin, funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike në pajtueshmëri me standardet e shërbimeve në fushën e turizmit.

Ligji për taksën e akomodimit për objekte hoteliere e turistike:

Ky dokument legjislativ përcakton normën e pagesës së taksës për shërbime të akomodimit në objekte hoteliere dhe mënyrën e pagesës të taksës për këto shërbime. Vlen të theksohet se kjo taksë nuk gjen zbatim.

Ligji i Turizmit aktual i cili ka hyrë në fuqi para pak ditësh.

XVII Objektivat e përgjithshme

XVII.1 Infrastruktura fizike

Infrastruktura fizike paraqet pjesë të rëndësishme që lidhet me zhvillimin e turizmit. Kjo fushë lidhet edhe me pjesën e orientimit të zhvillimit lokal, planeve investive dhe mundësive buxhetore. Në kuadër të infrastrukturës fizike preferohet rregullimi i rrugëve, rregullimi i ujësjellësit, kanalizimit, internetit, pastaj hartave turistike dhe shenjave për turistë.

XVII.1.1 Objektiva specifike

Rregullimi i rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, shportave të mbeturinave dhe rrjetit të internetit

- Treguesi 1

Gjendja e rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, shportave te mbeturinave dhe rrjetit të internetit është jo e mirë, sidomos në zonat turistike (shembull Jezerci). Ka ende rrugë pa asfaltuar, nuk ka rrjete të kanalizimit, nuk ka ujësjellës, shporta për mbeturina dhe nuk ka rrjet të internetit.

- *Aktiviteti 1*

Rregullimi i infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimit

Hapja e tualeteve publike asgjë më shumë nuk e dëmton përvojën e mirë të turizmit në një vend se sa nevoja e shpejtë për të vizituar tualetin. Në mënyrë që vizitorët, sidomos ata që vijnë për një ditë, të mos ballafaqohen me këtë problem, do të hapen tualetet publike në hapësira të cilat vizitohen me së shumti nga turistët. Këto tualete do të kenë një hapësirë të qasshme, me drita, ujë dhe do të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme.

- *Aktiviteti 2*

Vendosja e shportave për mbeturina dhe antenave për rrjet

Vendosja e shportave për hedhje të mbeturinave në hapësira publike turistët synojnë vende të pastra, ku mundësia e kanosjes së ndonjë infektimi është minimale. Mungesa e pastërtisë në hapësira publike është identifikuar si një nga problemet kryesore në hapësira publike nga turistë e huaj. Për ta ngritur nivelin e pastërtisë, do të sigurohet që hapësirat publike, sidomos ato afër lokacioneve turistike, të kenë shporta për hedhje të mbeturinave.

Ndërtimi i një teleferiku për në Malet e Jezercit – Jezerci është njëri ndër lokacionet më të vizituara në Komunën e Ferizajt. Ndonëse numri i vizitorëve është i madh, shumë të moshuar, për shkak të kufizimeve shëndetësore, nuk kanë mundësi të ngjiten për në shume vende, në këmbë. Disa të tjerë, sidomos ata një ditor, për të mos humbur kohë, e anashkalojnë këtë hapësirë. Për t'iu siguruar qasje komode për në malet e Jezercit , parashihet të ndërtohet një teleferik, i cili bën bartjen e vizitorëve nga poshtë dhe anasjelltas.

- Treguesi 2

Mungesa e tabelat orientuese dhe tabelave për vendet turistike, të gjithë e dijmë që në Kosovë tabelat orientuese janë të pakta për t'i orientuar vizitorët drejt destinacionit të tyre.

- *Aktiviteti 1:* Shenjëzimi
- *Aktiviteti 2: Hartat turistike*
- *Aktiviteti 3: Pikat informuese*
- *Aktiviteti 4: Shenjat turistike*

Objektiva specifike 2: Trajnimi, hapja e shkollave profesionale, bazat e të dhënave, tour operaturën, mbështetja e prodheusve vendor dhe përkrahja e mërgatës

Treguesi 1

Ne kemi mungesë të shkollave profesionale në fushën e turizmit, kemi mungesë të tur operatorëve, kemi mungesë të trajnimit të kulinarisë dhe gjithashtu pak mbështetje për prodhuesit vendor.

Trajnimi i akterëve të shërbimeve kulinare që t'i përshtaten kërkesave të turistëve të huaj vizitorët e huaj, sidomos aziatikët, janë të interesuar në kuzhinë tradicionale me porcione të vogla. Duke pasur parasysh këtë, do të organizohet një trajnim me instruktorë ndërkombëtar për përfaqësuesit e kulinarisë në Ferizaj. Qëllimi i këtij trajnimi do të jetë aftësimi i pjesëmarrësve mbi përshtatshmërinë e kuzhinës/shërbimeve konform kërkesave të vizitorëve.

Aktiviteti 1

Hapja e një shkolle profesionale të kulinarisë. Përkundër numrit në rritje të turistëve, në qytetin e Ferizajt nuk ka mjaftueshëm restorante me kuzhinë dhe shërbime cilësore. Edhe ato që ekzistojnë ankohen se nuk ka fuqi punëtore të përgatitur në kulinari. Për ta aftësuar fuqinë punëtore që të jetë e gatshme të përgatisë ushqime të cilësisë së lartë, do iniciohet hapja e një shkolle profesionale të kulinarisë, me staf të kualifikuar dhe program bashkëkohor, e cila do t'i shërbej të gjithë rajonit.

Aktiviteti 2

Mbështetja e tur-operatorëve lokal që të marrin pjesë në panaire ndërkombëtare tur-operatorët lokal nuk janë shumë të lidhur me tur-operatorë nga burimet kryesore të turizmit në Evropë. Për të pasur zhvillim të lidhjeve direkte me tur-operatorë në Evropë dhe për krijuar mundësi për të nënshkruar kontrata afatgjata, do të mbështet pjesëmarrja e vendorëve në panaire evropiane (si psh. "Destination Nature").

Aktiviteti 3

Të krijohet një bazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshirë edhe të hyrat që gjenerojnë

Mungesa e statistikave në lidhje me profilin, sjelljen dhe përshtypjen e vizitorëve të muzeve përbën një problematik serioze për t'i avancuar shërbimet bazuar në kërkesat reale të vizitorëve. Thënë këtë, konsiderohet e domosdoshme që të zhvillohet një platformë elektronike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për vizitorët e muzeve, e cila do të shfrytëzohet nga të gjithë muzetë që operojnë, por edhe me gjerë. Stafi që do ta përdor këtë platformë do t'i nënshtrohet një pakete trajnuese për t'u siguruar që i gjithë procesi i mbledhjes dhe përpunimi të bëhet në mënyrë standardizuar.

Aktiviteti 4

Tregu i prodhimeve vendore bujqësore

Rajoni i Ferizaj është i shquar për produkte ushqimore. Por, fatkeqësisht, ato nuk promovohen mjaftueshëm dhe nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për të depërtuar tek konsumatorët. Në mënyrë që sadopak të trajtohet ky problem, do të hapet/ndërtohet një treg në qendër të Ferizajt.

Aktiviteti 5

Shpallja e Korrikut dhe Gushtit si muaj të mërgatës

Duke qenë se fluksi më i madh i të rinjve të mërgatës është i koncentruar gjatë muajve korrik dhe gusht dhe duke ditur potencialin e tyre si segment, këta muaj do të shpallen "Muajt e Mërgatës", ku me ç'rast do të ofrohen lehtësira rregulluese për akterët (psh. zgjatje të orarit të punës).

XVII.2 Digjitalizimi dhe Marketingu

Digjitalizimi dhe marketing i turizmit në Komunën e Ferizajt

Zhvillimi i teknologjive të reja të informacionit është një kontribut i madh për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit. Për bizneset turistike, oferta e internetit është bërë burimi më i madh i informacioneve për prenotime në të gjitha periudhat kohore. Kjo ofertë virtuale e cila mund të transmetohet në shumë mënyra, ka racionalizuar dhe shkurtuar shpenzimet dhe kohën për operuesit turistik, ndërmjetësuesit dhe konsumatorët. Ndikimi i fuqishëm dhe dinamik i kësaj teknologjie e cila është bërë platformë e komunikimit masiv, mund të përmblidhet në shumë komponentë, por dy më kryesoret janë:

- Zhvillimi i TIK mund të ndryshoj strukturën e këtij sektori dhe rregullat e konkurrencës,
- TIK mund të përdoret për të krijuar avantazh të qëndrueshëm konkurrues dhe të siguroj kompanitë me instrumente të reja kualitative dhe sasiore konkurruese.

Sistemet e Informacionit Turistik (SIT) projektohen për të mundësuar integrimin e aktereve që punojnë në fushën e industrisë së turizmit. Sistemi projektohet për të lejuar një kontroll më të mirë dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të përditshme të anëtareve të SIT.

Disa nga karakteristikat kryesore të SIT janë:

- Një spektër i gjerë i informacionit të ofruar,
- Të dhëna ditore të rëndësishme,
- Kontroll i lehtë,
- Sisteme informacioni me karakter multimedial,
- Mundësi të pakufuzuara e të dhënave të paraqitura,
- Një numër i pakufuzuar i përdoruesve të rrjetit,
- Kosto e ulët operacionale.

Transformimi digjital i turizmit është i lidhur ngushtë me planin evropian të rimëkëmbjes dhe periudhën e re të programimit, e cila fokusohet në tranzicionin e gjelbërt dhe atë digjital të industrise turistike.

Sektori i turizmit, në aspektin teknologjik, duhet parë nga dy këndvështrime - nga ana e ofertës dhe nga ana e kërkesës. Për bizneset turistike, në ditët e sotme, oferta e internetit është bërë burimi më i madh i informacioneve për prenotime në të gjitha periudhat kohore.

SIT projektohen për të mundësuar kryesisht integrimin e kompanive që punojnë në fushën e industrisë së turizmit. Sistemi projektohet për të lejuar një kontroll më të mirë dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të përditshme të anëtarëve të SIT.

Në epokën e ekonomisë digjitale dhe të inovacioneve, qytetet në mbarë botën, këtu nuk duhet të bëj përjashtim edhe qyteti i Ferizajt, po e njohin gjithnjë e më shumë konceptin e qytetit të zgjuar të turizmit dhe strategjitë e lidhura me to si mjete për optimizimin e mjediseve të qëndrueshme turistike. Veçanërisht për qytetet që përballen me probleme në zhvillim e perceptimeve negative të banorëve ndaj turizmit, qyteti i zgjuar turistik fuqizon një qytet duke krijuar hapësira urbane që banorët dhe vizitorët mund t'i shijojnë së bashku. Megjithatë, iniciativat kërkimore të qyteteve të turizmit të zgjuar ende nuk arrijnë të adresojnë spektrin e plotë të lidhjeve dhe potencialeve zhvillimore turistike.

Qytetet e zgjuara turistike duhet të përfshijnë parimet bazë të zhvillimit të drejtë dhe të zgjuar turistik.

Një sistem i mirëfilltë i informacionit turistik për Komunën e Ferizajt nënkupton krijimin e një platforme lokale dixhitale që, në një pikë te vetme, do të bashkoj informacionin bazë për të gjithë turistët, lokalitetet e rëndësishme, ngjarjet, rrugët dhe të gjitha destinacionet potenciale turistike. Në këtë mënyrë, platforma do t'u mundësoj përdoruesve të kenë një pasqyrë të lokacioneve turistike në Komunën e Ferizajt në mënyrë të thjeshtë dhe efektive. Duke përdorur një shfletues interneti ose aplikacion celular me aftësi të avancuara kërkimi, sipas interesave ose llojeve të përmbajtjes, qëllimi kryesor i kësaj platforme është t'u mundësoj turistëve të marrin vendimin e lehtë, të qëlluar dhe të shpejtë për të vizituar një destinacion të caktuar turistik.

Një SIT turistik përfshin disa komponente:

- Asistenti digjital;
- Guida turistike digjitale;
- Zhvillimi i një platforme për rezervime akomodimi;
- Infrastruktura harduerike për zgjidhje aplikative;
- Ofrimin e internetit me shpejtësi të lartë në vendndodhje dhe ndërtimi i rrjeteve Ëi-Fi për vendet e trashëgimisë kulturore e historike.

XVII.2.1 Objektiva specifike

Rregullimi i ueb faqes turistike, aplikacioneve turistike dhe guidave, harta digjitale turistike

- Treguesi 1

Ka mungesë të ëebportaleve dhe aplikacioneve për turistë, ka pak materiale fizike ose broshura dhe harta për vendet turistike, nuk ka rrjet të internetit të mjaftueshëm,

- *Aktiviteti 1*

Ri-modelimi i Qendrës Informative të Turizmit për Komunë

- *Aktiviteti 2*

Sigurimi i të dhënave të sakta mbi numrin e vizitorëve dhe profilin e tyre (exit survey)

- *Aktiviteti 3*

Të krijohet një bazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshirë edhe të hyrat që gjenerojnë.

Mungesa e statistikave në lidhje me profilin, sjelljen dhe përshtypjen e vizitorëve të muzeve përbën një problematik serioze për t'i avancuar shërbimet bazuar në kërkesat reale të vizitorëve. Thënë këtë, konsiderohet e domosdoshme që të zhvillohet një platformë elektronike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për vizitorët e muzeve, e cila do të shfrytëzohet nga të gjithë muzetë që operojnë në Ferizaj por edhe me gjerë. Stafi që do ta përdor ketë platformë do t'i nënshtrohet një pakete trajnuese për t'u siguruar që i gjithë procesi i mbledhjes dhe përpunimi të bëhet në mënyrë standardizuar.

- *Aktiviteti 4*

Promovimi i turizmit tek turistët e huaj përmes " Digjitalizimit të informacionit turistik"

- *Aktiviteti 5*

Hartimi i guidës në platformën turistike Lonely Planet

- *Aktiviteti 6*

Digjitalizimi i hartës turistike me qëllimi të promovimit të pikave turistike në arenën ndërkombëtare.

- *Aktiviteti 7*

Pozicionimi i atraksioneve turistike në portalet online që shërbejnë si referencë për turistët e huaj, siç është tripadvisor.com e tjera të ngjashme.

XVII.2.2 Objektiva specifike-Marketingu

Promovimi i turizmit për turistët e huaj përmes " Digjitalizimit të informacionit turistik", përgatitja e një video spoti reklamues për turizmin, potencialet dhe përfitimet.

Treguesi 1

Mungesa e informacioneve digjitale dhe spoteve reklamuese.

- *Aktiviteti 1*

  Përpilimi, dizajnimi dhe shtypja e materialeve promovuese dhe hartave

- *Aktiviteti 2*

Vendosja e pllakave informative para hapësirave të trashëgimisë kulturore

- *Aktiviteti 3*

  Ndërtimi i ëeb portalit digjital për turizmin në Ferizaj

- *Aktiviteti 4*

  Përgatitja e një video spoti reklamues për turizmin, potencialet dhe përfitimet

XVII.3. Fshati: Jezrci,Nerodimja dhe fshtrat tjerë me potencial turistik

XVII.3.1 Objektiva specifike 1

Infrastruktura ne fshatin Jezerc dhe Neredime

Treguesi 1

Mungesa e infrastrukturës në fshatin Jezerc dhe Neredime. Fshati Jezerc dhe Neredime kanë ende mungesë të infrastrukturës.

Aktiviteti 1

Aktivizimin e pishinës së vjetër (rindërtimi i një pishine me dimensione më të mëdha)

Aktiviteti 2

Ndërtimin e verandave të hapura, bashkë me oxhaqet për përdorimin e zjarrit për përgatitje vetanake të ushqimit (skarë, etj.) Neredime

Treguesi 2

Fshati Jezerc është në mungesë të zhvillimit të madh të turizmit. Ne do të bëjmë qasjen sa më të lehtë për vizitorët.

Aktiviteti 1

Rregullimi i hapësirës së parkingut për automjete.

Aktiviteti 2

Rikonstruktimi i kalave në fshatin Jezerc.

Objektiva specifike 3 Infrastruktura e fshatit Neredime

Treguesi 1

Rregullimi dhe rikonstruktimi i rrugëve dhe objekteve në fshatin Neredime

Aktiviteti 1

Ndërtimin e shtegut të ecjes përreth lumit Neredime.

Treguesi 2

Fshati Neredime ofron shumë mundësi pr zhvillim të turizmit dhe tërheqjen e vizitorëve.

Aktiviteti 1

Renovimi i dy krojeve me rrjedhje të përhershme të ujit.

XIX. Monitorimi dhe Raportimi

Monitorimi i strategjisë do të bëhet çdo tre muaj nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe secilin vit Drejtoria do të përgatis raport për Kuvendin e Komunës së Ferizajt për gjendjen dhe ecurinë e zhvillimit të turizmit.

XX. Rekomandimet e adresuara për problemin

- Promovimi aktiv i turizmit, prezantim profesional i të gjitha segmenteve të turizmit në kuadër të ofertës turistike,
- Përgatitja dhe realizimi i programit për sigurimin e informatave dhe materialeve edukative për të nxitur dhe të mbështetur vlerat turistike;
- Krijimin dhe zhvillimin e një sistemi universal të informacionit të turizmit dhe lidhja me sistemet e tjera të informacionit;
- Në mënyrë aktive të promovohet potenciali i përgjithshëm i turizmit dhe rritja e bashkëpunimit me rajone tjera në vend dhe jashtë vendit, si dhe rritja e bashkëpunimit me organizata me famë botërore në sektorin e turizmit, operatorë turistik me qëllim të heqjes së turistëve nga vendet tjera. Të rritet koordinimi me të gjitha organizatat e turizmit, odat ekonomike, shoqatat, organizatat dhe institucionet e tjera në fushën e turizmit dhe mikpritjes.
- Subvencionimi i sektorit të turizmit;
- Pjesëmarrje aktive në evenimente të turizmit, me qëllim të tërheqjes së investimeve në industrinë e turizmit në Komunën e Ferizajt.